

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7432 E martë 6 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga DRITAN HILA



Arrestimi i cironkave që mund të sjellë peshqit

Arrestimet e disa drejtorësh Arrugësh kanë ngjallur një lloj ilariteti që nuk lidhet me entuziazmin. Një pjesë janë skeptikë se të ndaluarit nuk janë peshqit ...
Vijon në faqen 18

Dje

në "Evropa e Lirë"

Nga VALONA TELA



Serbia dhe Mali i Zi janë të vetmet svende të Ballkanit Perëndimor, të cilat në Strategjinë e Komisionit Evropian do të marrin afat të qartë kalendarik për ...
Vijon në faqen 19

Strategjia e re e BE-së: Vetëm Serbia dhe Mali i Zi marrin afate kohore



Forcat e Armatosura shpëtojnë të moshuarën, aksioni

Përmbytjet, Vjosa merr nën vete 230 banesa dhe 3000 hektarë tokë

Banorët e pallatit që rrezikun shembjen në Gjirokastrë kthehen në shtëpi

Ndërprerja e reshjeve të shiut ka çuar në përmirësimin e situatës në Fier dhe në Vlorë, ku si pasojë e vërshimit të ujërave të lumit Vjosa u përmbytën dhjetëra shtëpi e mijëra hektarë tokë. Dje lumi Vjosa është tërhequr në shtratin e tij, ndërsa ka rënie të ndjeshme të nivelit të ujërave në të gjithë pellgun Levan-Ura e Mifolit-Novoselë...

Në faqen 9

EKZEKUTIMI I DEVI KASMIT, ZBULOHEK E KALUARA E EFTIMI EFTIMIUT NE ATHINE

VRASESI GREK, ROJE NE AMBASADEN SHQIPTARE

E kaluara e agjentit special, u arrestua me kokainë në Gjermani. Dëshmitë në gjykatë, lihen në burg 4 të dyshuarit kryesorë të atentatit te Peditria



(Në foto) Autori i dyshuar, Eftimi Eftimiu dje në gjykatë

Në faqen 7

DEBATET

Lista finale e KLP dhe KLGJ, kush janë 10 kandidatët, ikën nga lista ish-sigurimi

Në faqen 4

PAS ARRESTIMEVE TE BUJSHME

Tiranë-Elbasan, hetim edhe për ish-ministrin Haxhinasto, ç'është kallëzimi në prokurori

Në faqen 8

KOMISIONI EUROPIAN

Sot del Strategjia për zgjerimin e BE: Ballkani Perëndimor s'mund të anëtarësohet

Në faqen 3

ÇFARE NDODDHI

Atentati ndaj Çapjave në 2016, ndryshon akuza për 'vrasësin', mbetet në tentativë

Në faqen 17

"KAMARJA E TURPIT"



Kadare e Orhan Pamuk, kandidatë për çmimin ndërkombëtar në Angli, flet kryetarja e jurisë

Në faqen 16

Interpelanca, ministri i Jashtëm: Nuk jemi ndierë të kërcënuar nga Greqia

Pakti detar, Bushati: Do të jetë i drejtë

"12 mijet? Shpifje. Çamët, çështje e të drejtave të njeriut"

Nga DARINA TANUSHI

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, deklaroi dje se "marrëveshja për detin me Greqinë do të jetë e bazuar në vijat e kuqe që në kemi hequr, mbështetur në të drejtën ndërkombë-



tare, legjislacionin e brendshëm". Në një interpelancë me studentë të ekselencës, përmes platformës së bashkëqeverisjes "shqipëriaqeduam.al", Bushati mohoi çdo lloj presioni për t'u ulur në bisedime, ardhur nga ...

Në faqen 2

DISKUTIMET ME GREQINE MINISTRI

Interpelanca, ministri i Jashtëm: Nuk jemi ndierë të kërcënuar nga Greqia

Pakti detar, Bushati: Do të jetë i drejtë e i zbatueshëm

"12 miljet? Shpifje. Çamët, çështje e të drejtave të njeriut"

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë, Dimitri Bushati, deklaroi dje se "marrëveshja për detin, me Greqinë do të jetë e bazuar në vijat e kuqe që ne kemi hequr mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, legjislacionin e brendshëm". Në një interelancë me studentë të ekselencës, përmes platformës së bashkëqeverisjes "shqipëriaeduam.al", Bushati mohoi çdo lloj presioni për t'u ulur në bisedime, ardhur nga kushdo palë, për shkak të çeljes së negociatave në kuadër të integritimit evropian. Ai tha se brenda 6-mujorit të parë presim që Greqia të shfuqizojë Ligjin e Luftës.

DISKUTIMET PËR DETIN ME GREQINË

Në përgjigje të pyetjes së studentes së ekselencës për atë se çfarë është diskutuar sa të përket kufirit detar, Bushati tha: "Kemi një marrëveshje, e cila u shfuqizua nga ana e Gjykatës Kushtetuese. E për pasojë, për qeverinë "Rama", vendimi i Gjykatës Kushtetuese është pika e nisjes për çdo lloj diskutimi të mundshëm të një marrëveshjeje të re me Greqinë. Së dyti, natyrisht Shqipëria është në vend anëtar i OKB-së, siç është Greqia. Është palë e Konventës së Detit, siç është gjithashtu Greqia. Çka do të thotë që për Shqipërinë dhe Greqinë, buronjë disa të drejta dhe detyrime nga ana e Drejtës Ndërkombëtare dhe këto të drejta dhe detyrime nuk mund të jenë fakultative as për ne dhe as për Greqinë. Pra, pika e dytë e konturit tonë mbi të cilën e kemi ndërtuar gjithë strategjinë e diskutimit tonë me Greqinë, natyrisht është e Drejtës Ndërkombëtare. Së treti - vijoi ministri Bushati - Shqipëria dhe Greqia kanë legjislacion të brendshëm, që është i aplikueshëm në këtë fushë dhe kur dy palët duan të ulen dhe të diskutojnë, natyrisht që marrin për bazë edhe legjislacionin e brendshëm. Ne, që në 2013-ën kemi bërë disa diskutime eksploratore me palën greke, sepse ka qenë dhe mbetet në interesin tonë dhe të Greqisë për të gjetur një zgjidhje të arsyeshme për këtë çështje. Kemi konsultuar ekspertizë të huaj, në mënyrë individuale dhe në mënyrë paralele tri lloje të ndryshme të ekspertizës, përfshirë edhe një ekspertizë të marrë nga qeveria e kaluar. Konkudoj në faktin që çdo lloj marrëveshjeje e re që do të duhet të arrihet me palën greke, do të jetë detyruesisht më e mirë se ajo që u arrit në 2019-ën, për shkak të gabimeve trashanike që bëri qeveria "Berisha" goftë në thelb, apo edhe në procedurë. Në thelb, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është shumë i qartë, mbi bazën e teknikës



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë, Dimitri Bushati, dje në një interelancë me studentë të ekselencës

dhe parimit që është përdorur për atë marrëveshje. Në procedurë gjithashtu vendimi i Gjykatës Kushtetuese flet shumë qartë për mungesën e plotfuqishmërisë që kishte grupi negociator nga ana e Presidentit të Republikës në atë kohë", sqaro Bushati. Sipas tij, "diskutimet kanë qenë të një karakteri politiko-diplomatik, duke balancuar pikëpamjet precedent të së drejtës ndërkombëtare për këtë çështje. Siç dihet, ka ndjekur një metodë të baraslargësisë, persa i përket ndarjes së detit, nëse mund ta përdorim si term më popullor. Ne duam që të ndjekim më përpikmëri vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese, duke kombinuar parimin e baraslargësisë me parimin e rregullimit, që vjen si pasojë e gjeografisë që ka Greqia dhe Shqipëria në këtë pikë. Jemi plotësisht të bindur që duke respektuar të drejtën ndërkombëtare, duke respektuar vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese, Shqipëria do të ketë një marrëveshje disa herë më të favorshme dhe më të drejtë se ajo e 2009. Por besojmë gjithashtu që edhe Greqia, përmes këtij procesi, do të lidhë një marrëveshje të re me Shqipërinë, e cila do të jetë e zbatueshme edhe në praktikë, sepse të dyja vendet kanë kuptuar gjatë këtyre 6-7 viteve që nuk është e rëndësishme të kesh një marrëveshje vetëm në letër,

por duhet të kemi një marrëveshje, e cila duhet të jetë e drejtë, e ndershme dhe e zbatueshme në praktikë", u shpreh Bushati. **12 MILJET** "Cdo diskutim në media apo në hapësirën publike për të ashtuquajturën 12 milje apo për "falje" a "shitje" të zonave naftëmbajtëse, të gazsjellësve nga ana jonë të Greqia është thjesht një shpifje dhe koha do ta vërtetojë në momentin që grupi i punës do të ulët dhe do të kthehet në një grup negociator mbi bazën e një plotfuqishmërie të qartë që do të merret nga Presidenti i Republikës, që përcakton ligji dhe Kushtetuta për çështje të tilla. Dhe ne shpresojmë që në një kohë jo të largët, të kemi këtë marrëveshje të re, e cila do të jetë disa herë më e favorshme", sqaroi Bushati.

REAGIMI

"Lexova një nga eksponentët e Partisë Demokratike që thoshte: '...Berisha i fali disa xhepa det, ndërsa kjo qeveri po i fal naftën edhe gazin'. Një qëndrim totalisht i papërgjegjshëm, se si mund të thuash që fali disa xhepa det, a thua se është pronë private apo pronë personale e Berishës apo e kësaj qeverie, deti. Mund t'ju them që i gjithë ky proces, që ka kohë që ka nisur me diskutime eksploratore, do të finalizohet me një marrëveshje shumë të mirë, të drejtë, të ndryshme, ku të dyja palët marrin atë çka i takon".

LIGJI I LUFTËS

Në lidhje me ligjin e luftës, Bushati tha: "Së pari, ne jemi dy vende anëtare të NATO-s, pra nuk ndjehemi të kërcënuar në kuptimin ushtarak të fjalës nga ana e Greqisë, por nga ana tjetër, gjendja e luftës ekziston, ndonëse pas shumë e shumë vitesh duhet të përsëritet faktin që një qeveri greke e pranon zyrtarisht që kjo gjendje lufte është një relike e së kaluarës, e cila duhet të shfuqizohet". Ai shpjegoi se pala shqiptare ka kërkuar që "ligji i luftës apo dekreti mbretëror që sanksionoi regjimin e luftës përkundër Shqipërisë dhe që vuri nën sekuestro konservative një pjesë të mirë të pronave të shtetit shqiptar, qytetarëve shqiptarë dhe qytetarëve shqiptarë me kombësi greke, sepse janë tri kategori, duhet të shfuqizohet me një akt po të njëjltë, pra që ka të njëjtin fuqi ligjore në sistemin juridik grek". Dhe ky akt i njëjltë, sipas Bushatit, nuk mund të ishte kurrësi një kontratë e dyanshme apo një marrëveshje e re ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, për sa

kohe Shqipëria nuk ka një regjim të tillë ndaj Greqisë, por veçse shfuqizimi i dekretit mbretëror me një dekret, i cili do të duhet që të firmoset nga presidenti grek dhe të kundër firmohet nga qeveria greke, siç përcakton legjislacioni i brendshëm grek. "Po kështu, përmes këtij procesi, ne do të kemi një situatë të re politike ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, sikundër do t'i jepet mundësia të tri kategorive që unë lista për t'u drejtuar instancave greke, goftë në kuptimin administrativ të fjalës apo edhe gjyqësor për të gëzuar të drejtën e pronësisë, sepse në analizë të fundit, Greqia është një vend anëtar i Këshillit të Evropës dhe në një mënyrë a në një tjetër, zbaton jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e të drejtës pronësore", u shpreh Bushati.

ÇËSHTJA ÇAME

Sa i përket çështjes çame, Bushati sqaroi se "qeveria Rama" më 2013-ën është qeveria e parë shqiptare që zyrtarisht në programin qeveritar



Parlamenti Evropian

në kapitullin për politikën e jashtme e përfshiu këtë çështje si pjesë të dosjes sonë diplomatike. Për ne, kjo nuk është fare një çështje e karakterit territorial apo irredentist, siç përpigjen ta përshkruajnë politikanë të ndryshëm në Greqi. Për ne, kjo është një çështje e lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut, siç shkruhet në programin tonë qeverisës apo në dokumentin strategjik që ne kemi shkëmbyer me qeverinë greke, me palën greke në 2016-ën dhe që më pas, si qeveria shqiptare ashtu edhe qeveria greke, e kanë deponuar pranë shërbimeve të Komisionit Evropian. Pra, është një çështje e lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut, që në radhë të parë lidhet me përgjegjësinë individuale që kanë qytetarët sot e gjithë ditën si në Greqi, ashtu edhe në Shqipëri", tha Bushati. "Së dyti - tha Bushati - flasim për të drejtën e lëvizjes së lirë në përputhje me parimet e Schengen-it dhe për këtë ai shtoi se janë në një pozicion më të favorshëm se para disa viteve me palën greke".

VETOJA GREKE NË BE

"Është shumë e vërtetë që Bashkimi Evropian për raste të tilla merr vendime unanime apo nevojitet një konsensus për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Por, më duhet ta them që në asnjë moment nuk e kemi ndjerë veten të kërcënuar në këto bisedime, të cilat kanë disa vite që zhvillohen, ndonëse nga 2016-ta në kuadër të mekanizmit të dialogut, që ne vendosim me palën greke janë bërë në mënyrë shumë intensive, sepse ne besojmë që në radhë të parë nuk është në interesin strategjik të Greqisë që të përdorë një politikë bllokuese ndaj Shqipërisë, sikundër në interesin tonë strategjik është që Greqia të jetë një prej mbështetësve kryesorë për anëtarësimin tonë në BE", tha Bushati.

PDIU i përgjigjet presidentit grek: Sado të kërcënosh me veto, çamët ekzistojnë

dhe përbuzjes. Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë minimumin e dinjitetit dhe të interesit kombëtar duke reaguar ndaj fyerjeve, përndryshe turpi i bjerres së interesave kombëtare do t'i ndjekë nga pas përjetë", shpreh PDIU. Sipas kësaj partie, "çështja çame është gjallë, ekziston dhe do të mbetet e

këfillë, derisa të zgjidhet. Prandaj, ja ku po i themi presidentit 'trim': Sado të kërcënosh me veto, pa veto, me ushtarë e pa ushtarë, çështja çame ekziston, përdërisa në bijtë e Çamërisë marrim ende frymë. Nëse na do përballë, përballë do na kesh!", thuhet në deklaratën e PDIU-së.

Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet si dhe shoqata patriotike atdhetare "Çamëria", ka reaguar pas deklaratave kërcënuese të presidentit grek, Prokopis Pavlopoulos, i cili tha nga një bazë ushtarake se Shqipëria nuk duhet ta përmendë çështjen çame. "PDIU i bën thirrje qeverisë shqiptare të reagojë përpara këtyre deklaratave të papranueshme. Është e tepërt heshtja përballë fyerjes



Komisioni Evropian paraqet sot Strategjinë për Zgjerimin

BE-ja për Ballkanin Perëndimor: Nuk mund të anëtarësohen në këtë gjendje

"Shteti ligjor dhe qeverisja e mirë, pikë referimi"

Armand Mero

Komisioni Evropian pritet të paraqesë sot Strategjinë për Zgjerimin me vendet e Ballkanit Perëndimor. Dokumenti, një kopje të të cilit "Zëri i Amerikës" e ka siguruar, ripërcakton nga njëra anë detyrimet kryesore që vetë vendet e rajonit duhet të përmbushin, me përqendrim të veçantë në shtetin ligjor dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe mes tyre, ndërsa nga ana tjetër, flet për një angazhim në rritje të vetë Bashkimit Evropian për t'i mbështetur në shumë këto vende në rrugëtimin e tyre. Që në hyrje të Strategjisë për Zgjerimin, saktësohet se vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian "por jo në kushtet në të cilat ato janë aktualisht". Dokumenti njih përparimin e bërë ndër vite "por në mënyrë që vendet të përmbushin të gjitha kushtet e anëtarësimit dhe të forcojnë demokracitë e tyre, ende kërkohen reforma gjithëpërfshirëse dhe bindëse në fusha vendimtare" duke veçuar tri drejtimet kryesore: sundimin e ligjit, konkurrueshmërinë dhe bashkëpunimin rajonal e pajtimin. Inj në rëndësië parësore për BE-në konsiderohet "forcimi i ndjeshëm i shtetit ligjor". Panorama e sotme që vizatohet nga dokumenti paraqitet problematike, ndërsa fillet për "elemente të garta të kapes së shtetit, duke përfshirë lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe administratës, si dhe një përzierje të fortë mes interesave publike dhe atyre private", gjë e cila "ushqen një ndjenjë të mosndërkimit dhe pabarazisë". Dokumenti flet për ndërhyrje të gjera politike dhe kontroll të medieve. Shteti ligjor, të drejtat themelore dhe qeverisja e mirë konsiderohen si "një pikë kyçe referimi, në bazë të së cilës vendet do të gjykojnë nga BE-ja", ndërsa vihet theksi se nevoja për reformat në sistemin gjyqësor që do të sig-



EKONOMIA

"Asnjë prej ekonomive të Ballkanit Perëndimor, aktualisht nuk mund të konsiderohet një ekonomi tregu funksionale dhe as të ketë kapacitetin për të përballuar trysninë konkurruese dhe forcat e tregut në Bashkimin Evropian", vlerëson Strategjia.

urojnë "funsionimin e paruar, cilësor dhe efikas të tij". Ekonomia është fusha tjetër e rëndësishme, ku sipas BE-së kërkohen transformime rëndësore. "Sektorët kritikë të ekonomive të rajonit janë jokonkurruese, me shumë ndërhyrje të pa-nevojshme politike dhe një sektor privat të pazhvilluar. Asnjë prej ekonomive të Ballkanit Perëndimor aktualisht nuk mund të konsiderohet një ekonomi tregu funksionale dhe as të ketë kapacitetin për të përballuar trysninë konkurruese dhe forcat e tregut në Bashkimin Evropian", vlerëson Strategjia. Për Bashkimin Evropian ka një rëndësi të dorës parë që ndërsa vendet e rajonit përparojnë për t'u bashkangjitur, ato të kenë lënë pas të gjitha problemet mes tyre, përmes zgjidhjeve përfundimtare. "Ende ekzistojnë mosmarrëveshje të rëndësishme dypalëshe midis vendeve të rajonit, të cilat mbeten për t'u zgjidhur: BE-ja nuk do të pranojë të importojë këto mosmarrëveshje dhe paqëndrueshmërinë që mund të sjellin".

KOSOVA E SERBIA

Në dokumentin e siguruar nga "Zëri i Amerikës" përmendet specifikisht situata

mes Serbisë dhe Kosovës. "Pa një normalizim efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve Beograd-Prishtinë nëpërmjet dialogut të lehtësuar nga BE-ja, nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe normalizim i detyrueshëm për normalizimin është urgjente dhe vendimtare, në mënyrë që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugët e tyre evropiane".

Por, ndërsa përcakton rrugën që duhet të ndjekin vendet e rajonit, Komisioni Evropian flet edhe për një angazhim të rritur të Brukselit ndaj Ballkanit Perëndimor në mbështetje të rrugëtimin të tij të integritimit. "BE-ja duhet të mbetet e besueshme, e vendosur dhe e drejtë, duke përmirësuar politikën e saj për të mbështetur më mirë procesin e transformimit në rajon. Dhe duhet të përmbushë angazhimet e veta, ndërsa Ballkani Perëndimor i përmbush ato në interesin e vet strategjik të Evropës", përcakton dokumenti. Sipas Strategjisë së Zgjerimit, "BE duhet të forcojë politikën e saj të angazhimit kundrejt Ballkanit Perëndimor, duke u përqendruar në fusha me interes të

përbashkët, siç janë drejtësia dhe çështjet e brendshme, duke përfshirë sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar, ekonominë dhe tregun e vetëm, energjinë, transportin dhe politikën digjitale, politikën sociale si dhe në çështjet e jashtme dhe të mbrojtjes. Bashkëpunimi në këto fusha - saktëson dokumenti - do të mbështetet nga pjesëmarrja me e madhe e Ballkanit Perëndimor në këshillat joformale, si dhe në kontaktet e rregullta të nivelit ministror. Komisioni nga ana e tij do të përfshijë, sipas rastit, Ballkanin Perëndimor në komitetet teknike dhe grupet punuese të komisionit. Pas samitit të Ballkanit Perëndimor në Sofje në maj 2018, udhëheqësit e BE-së duhet të vazhdojnë të angazhohen me homologët e tyre në Ballkanin Perëndimor".

Komisioni Evropian flet edhe për nevojën e një mbështetjeje më të madhe financiare ndaj rajonit. "Politikat e brendshme të BE-së dhe programet e financimit duhet të shtrihen më tej në Ballkanin Perëndimor si dhe mbështetja që ofrohet, në këtë mënyrë ato do të përdorin më mirë pjesëmarrjen ekzistuese në këto programe dhe rrjetet e BE-së. Komisioni do të rrisë ndihmën e tij teknike për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i ndihmuar ato të përfaqësohen në legjislacionin e BE-së dhe për të siguruar zbatimin e saj efektiv në praktikë". Strategjia parashikon një plan veprimi me masa konkrete në një seri fushash. Dokumenti i cili paraqitet sot, nënvizon se "anëtarësimi në BE është një zgjedhje. Ajo ka nevojë për konsensus politik dhe shoqëror dhe mbështetje të zemrave dhe mendjeve të njerëzve. Nuk mund të ketë paqartësi nga udhëheqësit rreth përkatësisë së Ballkanit Perëndimor dhe drejtimin në të cilin po shkon. Kjo - thekson Strategjia e Zgjerimit - është e domosdoshme për të siguruar dhe mbështetjen e qytetarëve të tyre dhe të qytetarëve të BE-së dhe duhet të pasqyrohet në komunikimin e liderëve dhe në kontaktet me qytetarët".

Intervista ndryshe, Rama: Kam frikë t'u ngjaj atyre që budallepsen duke u plak

Kryeministri Edi Rama ka folur në një intervistë për emisionin "Prive", për gjëra më private të tijat se politika. Në 60 sekonda, ai shprehet se paraja është "asgjë" për të, ndërsa ajo që e irriton është "badallallëku. Sa i përket asaj se kujt ia ka frikën, Rama shprehet: "Që t'u ngjaj atyre që budallepsen duke u plak".

Paraja për ty është...?

Asgjë!

Cilën femër nuk do ta refuzoj?

Gruan time.

Sa herë në jetë të është thyer zemra?

Aq herë sa më është ngjitur.

Femrat a duhet ta kenë frikën?

Mua? Joo!

Ç'ka të irriton?

Budallëllëku.

A je i dashuruar pas orëve?

Jo, pas kohës po që vrapon dhe unë i shkoj nga mbrapa.

Ku do të shkosh pasi të ikësh prej këtu?

Ku të më çojë Baton Haxhiu.

Cila është fjala e ndyrë që përdor?

Nuk e them.

A e gjen veten te filmi "50 hijet e Greit"?

Nuk më pëlqen fare ai film.

Dashuria, a mendoni që është sëmundje?

Jo. Dashuria është melhem.

Kujt ia ka frikën?

Që t'u ngjaj atyre që budallepsen duke u plak.

A ka urretje në zemrën tënde?

Jo, sepse siç thoshte gjyshja ime "inatit i madh, e zeza e të zot".

Çfarë muzike dëgjon?

Përgjithësisht klasike, po ndonjëherë edhe çka të dalë përpara.

Çfarë bën me rrobat e vjetra?

Çfarë bëj unë me rrobat e vjetra në fakt?! Mblidhen aty dhe më vjen keq që t'i hedh se nuk i bëjnë kujt.

Për çfarë të ka marrë malli?

Për çunin tani.

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

"Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvilloi ankandin e treta për shijen e pasurisë se paluajtshme "1/4 pjesë ideale takuese e dëbtorit Hysen Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme e kjojt apartament, me numër pasurie 4/89+1-3, Volumi 11, Faqe 23 në Zonën Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe prej 79.94 m², e ndodhur në Tiranë. Adresa: Rr. Qemal Stafa, Shkalla 1, Kat 2, Ap.3", për shijën e detyrimin në favor të kreditorit Rolik Çepeli, për shumën 17.400 Lëst dhe 163.992 lekë. Çmimi më të cilin fillon ankandi i treta është në vlerën 932.478.78 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tete pike shtatëdhjetë e tete) lekë. Ankandi i treta zhvillohet në datë 14.02.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, k.l.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471, 0695370060, email : ermirgodaj@zyraperbarimit.com."

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvilloi ankandin e dytë për shijen e pasurisë se paluajtshme "1/4 pjesë ideale takuese e dëbtorit Hysen Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme totale 186.70 m², nga e cila ndetese me sip. 62.70 m², e ndodhur në Rr. "Haxhi Sinai", Tiranë, për shijën e detyrimin në favor të kreditorëve Shasime Mera, Ajet Dema, Lirim Kasraji, për shumën 50'144 (nëntëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e kater)Euro dhe 890'015 (tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë. Çmimi fillëstar më të cilin fillon ankandi është në shumën 67'200 (gjashtëdhjetë e shtate mijë e dyqind)Euro. Ankandi zhvillohet në datë 12.02.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, k.l.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyraperbarimit.com."

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
SHOQËRIA PËRMBARIMOR "EXECUTORS LITUM" (EXC LIT) sh.p.k

Shoqëria Përbarmimore "Executors Litium" sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e paluajtshme :

Njësi me nr. Pasurie 6/121-N12, vol 22, fq.28, e regjistruar në ZVRPP Tiranë ZK 8160, me sipërfaqe 37 m², në pronësi të Albert Sokol Elezi
Çmimi më të cilin do të fillon ankandi është në vlerën 20.720 Euro
Ankandi do të zhvillohet në datë 05.03.2018 ora 16.00, në zyrën përmbarmimore "Executors Litium" sh.p.k, me adresë Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kat 4, ap 10, Tiranë.

DREJTËSIA SHORTI

Valentina Madani


Komisioni ad hoc për zgjedhjen e organeve të reja të drejtësisë zgjodhi dje me short listën përfundimtare për KLGJ dhe KLP, e cila i dërgohet Kuvendit për votim. Pasi u rrezua dy herë në Kuvend, për shkak se për miratimin e listës duhen 94 vota, faza e tretë e shortit ka mekanizëm zhbllokues, gjë e cila do të thotë se edhe nëse lista nuk merr 94 vota në Kuvend, ajo hyn në fuqi automatikisht. Shorti i djeshëm zgjodhi mes debatesh 10 kandidatët, të cilët në rast se nuk ka surpriza, do të jenë anëtarët përfundimtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. 5 anëtarët, pjesë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të jenë Nurihan Seiti dhe Tartar Bazaj nga radhët e avokatëve, Gent Ibrahim dhe Sandër Becina nga radhët e pedagogëve dhe Alfred Balla si pjesë e shoqërisë civile. Ndërsa 5 anëtarët që do të jenë pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të jenë Fatmira Luli dhe Alban Toro nga radhët e avokatëve, Erion Muharemaj dhe Maksim Qoku nga radhët e pedagogëve dhe Naurela Llagami si pjesë e shoqërisë civile. Pas 3 raundeve, opozita nuk dha konsensus për këto emra, duke e quajtur këtë proces si antikushtetues dhe të padenjë, për shkak se sipas saj, kandidatët kishin probleme me ligjin. Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi deklaroi se shorti është i paligjshëm, pasi kandidatët nuk janë në përputhje me ligjin. "Dy organet më të larta, KLGJ dhe KLP i kanë sot themelet të vendosura në antikushtetutshmëri", deklaroi demokrati Oerd Bylykbashi. Deputeti demokrat paralajmëroi Manjën disa herë që "në atë vazo nuk mund të futen kandidatët e zhvlerësuar nga ONM-ja. Është një procedurë që nëse vazhdon, është në kundërshtim me ligjin dhe shorti është i paligjshëm", tha z. Bylykbashi. Ndërkohë, kryetari i Komisionit të Posaçëm, Ulsi Manja falënderoi kandidatët që morën pjesë në konkurrim dhe u kërkoi që të respektojnë Kushtetutën. "Të zbatojnë me korrektesë Kushtetutën dhe ligjin, të jenë larg ndikimeve politike", u shpreh socialisti Manja. Lista do të votohet në bllok në seancën parlamentare në parlament, ku edhe nëse nuk i marrin 94 vota që kërkohen, lista quhet e miratuar. Lista mund të rrezohet vetëm nëse 94 deputetë do të votojnë kundër saj.

PËRJASHTIMI
Kozma Jano, kandidat nga radhët e prokurorëve për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, u skualifikua nga gara pas denoncimit të PD se ka qenë anëtar i Sigurimit të Shtetit, si dhe ka mbajtur notëkn "Telefoni". Sipas selisë blu, Kozma Llaqi Jano i ditëlindjes 1956 në Lushnje, është rekrutuar nga Sigurimi i Shtetit në 29 qer-

Hidhet shorti mes debatesh, PD: Procesi, antikushtetues. PS: Jo ndikime politike

Përzgjidhen 10 emrat, lista finale e KLGJ dhe KLP

Përrjashtohet nga gara i akuzuari si ish-sigurims




DESHTIMI

Pas dështimit të dy listave në parlament, të cilat nuk arritën të merrnin 94 vota, aq sa duheshin për të kaluar, këtë herë votat në Kuvend nuk janë më vendimtare. Sipas ligjit, edhe nëse kjo listë nuk merr 94 vota sa thotë ligji, lista me 10 anëtarët për këto dy këshilla do të konsiderohet e miratuar, duke e hapur rrugë ngritjes së këtyre institucioneve.

HIDHET SHORTI

- Anëtarët jomagjistratë të zgjedhur me short për KLGJ:**
- Kandidatët nga avokatia për KLGJ: Fatmira Luli dhe Alban Toro
 - Kandidatët nga pedagogët për KLGJ: Erion Muharemaj dhe Maksim Qoku
 - Kandidatët nga shoqëria civile për KLGJ: Naurela Llagami
- Anëtarët jomagjistratë të zgjedhur me short për KLP:**
- Kandidatët nga avokatia për KLP: Znj. Nurihan Seiti (Metaj), Tartar Bazaj
 - Kandidatët nga pedagogët për KLP: Gent Ibrahim, Sandër Beci
 - Kandidati nga shoqëria civile për KLP: Alfred Balla

Kreu i PD: Asgjë s'do jetë normale në seancë Basha: Të enjten, interpelanca me Gjonajn të jetë e fortë



POROSIA

"Interpelanca me ministrën e Drejtësisë, Etilda Gjonajn, do jetë një seancë e fortë kundër kapjes së çdo institucioni për t'i shërbyer mbrojtjes së Tahirit, të kimit, të ministrave të korruptuar", është shprehur kreu i PD-së.

Qëndrim në mbrojtje të varfërisë dhe qytetarëve, rinisë dhe ekonomisë. Paligjshmëria dhe padrejtësia e mazhorancës nuk ka kufi. Ata janë në panik. Shpirti, syri, veshi dhe zëri i qytetarëve duhet të jemi në", mësohet të jetë shprehur

z. Basha. Kreu i PD-së ka porositur deputetët për një seancë të fortë ditën e enjte, ku sipas tij të nxirret në pah kapja e institucioneve nga kryeministri Rama për të mbrojtur Saimir Tahirin dhe të tjerë ministra e politikanë. "Interpelanca me

shor 1977, pra 21 vjeç në kategorinë "Informatör" me pseudonimin "Telefoni". Sipas kartelës model 2 të publikuar në kohën e denoncimit nga PD, veprimtarinë ai do ta kryente në portin e Durrësit. Dokumenti mban firmën e zëritullarit Kapllan Shehu. Në mbledhjen e djeshme të komisionit ad hoc për zgjedhjen e organeve të reja të drejtësisë, Ulsi Manja, deputet i PS dhe njëherazi anëtar i Komision-

it të Ligjeve, ka propozuar që Jano të mos jetë me pjesë e shortit. Ndërkohë, Manja kërkoi nga Autoriteti për Hapjen e Dosjeve që të rifillojë verifikimin për Kozma Janon, pasi edhe vetë kandidati ka kërkuar të verifikohet e shkruara e tij, ndërsa më herët ka mohuar akuzat në adresë të tij. "Nuk jam përfshirë në asnjë marrëdhënie me Sigurimin e Shtetit, por as si individ dhe as në ushtrimin

e profesionit tim nuk kam dëmtuar asnjë person, në asnjë lloj forme, si gjatë diktaturës ashtu edhe gjatë demokracisë. Letra e bakallit me sfond të zi dhe 'stillops blu' që u publikua sot, është një sjasjë e shkruar me dorën e atyre që akuzuan, vetëm e vetëm me qëllimim e përballjes së emrit tim", tha Jano. Kozma Jano u përzgjodh në pesëshen e parë të shortit për në KLP, i cili u rrezua nga Ku-

vendi, ndërkohë që në shortin e dytë, pas rrezimit gjithashtu nga Kuvendi, emri i tij nuk doli nga goglat fituese. Herën e tretë që lista do të rrezohet në Kuvend, Kozma Jano nuk do jetë pjesë e shortit për anëtar të KLP. Lista e cila do dalë nga goglat do t'i çohet Kuvendit seancën e të enjtes për t'u hedhur në votim. Nëse kjo listë nuk merr 94 vota, ajo miratohet automatikisht.

PETRIT VASILI
Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili tha dje se me hedhjen e shortit për KLP dhe KLGJ u asgjësua ONM-ja. Sipas tij, drejtësia që po krijohet është e kapur totalisht nga kryeministri dhe po realizohet në drejtësi antireforma më e rrezikshme e pluralizmit.



LSI largon
Naçon nga
ad hoc-u për
KLGJ-KLP, çon
Silva Cakën

LSI largoi dje ish-ministrin e Drejtësisë, Nasip Naçon nga nënkomisioni ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Largimi i Naçon është bërë me kërkesë të Lëvizjes Socialiste për Integritim dhe kërkesa është votuar nga komisioni në mbledhjen e kësaj të hënë. Vendi e Nasip Naçon do e zërrë deputetja tjetër e kësaj force politike, Silva Caka. Deputetja e qarkut të Beratit mori mandatin pak ditë më parë, pas shkarkimit të Gledion Rehovicës, i cili rezultoi me probleme me drejtësinë italiane. LSI nuk e kundërshtoi këtë lëvizje, por përkundrazi, Kryemadhi mbështeti hyrjen në Kuvend të Silva Cakës.

"Gjoka Konstruksion" do të nisë investimet, qeveria do shlyejë 240 milionë euro për 13 vjet

Ornela Manjani

Firmoset kontrata për ndërtimin e Rrugës së Arbrit

Gjikhuri: Kompania do të ndërtojë rrugën me shpenzimet e veta

Kompania, e cila fitoi koncesionin për Rrugën e Arbrit tashmë mund të nisë zyrtarisht punimet. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bëri të ditur dje firmosjen e kontratës së koncesionit me "Gjoka Konstruksion" në mjediset e kësaj ministrie. Rruga e Arbrit do të kush-tojë 240 milionë euro dhe shteti do të përfundojë pagesat kundrejt kompanisë brenda 13 vitesh.

KONTRATA

Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë bëri me dije se është nënshkruar kontrata me kompaninë Gjoka Konstruksion për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Kontrata ka në objekt përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit. Kontrata me kompaninë fituese të garës u firmos nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Gentian Keri dhe presidenti i kompanisë "Gjoka Konstruksion" Rrok Gjoka. Në përfundim të ceremonisë së firmosjes, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z.Damian Gjikhuri deklaroi se kontrata u përmbyll pas një procedure të gjatë konkurrimi dhe negociimit intensiv. "Jemi shumë të bindur që shoqëria, nga diskutimet dhe ato çka na prezantoi gjatë negociatave të kontratës i ka marrë të gjitha masat që brenda afatëve të përcaktuara në kontratë, pra brenda këtij viti do të realizohet pjesa e financimit dhe fillimi i punimeve të rrugës. Është një nga veprat e rëndësishme, një lajm shumë i mirë për qytetarët shqiptarë por mbi të gjitha për qytetarët dibranë, të cilët prej shumë vitesh e kanë pritur këtë rrugë", u shpreh ministri Gjikhuri. Sipas tij, kemi të bëjmë me një të vështirë, një veprë të rëndësishme, por që do të jetë nga pikëpamja inxhinierike, një nga veprat më të realizuara në Shqipëri. "Është një veprë që do të kush-tojë 240 milionë euro dhe në këtë kontratë ne kemi parashikuar që shteti do të marrë përsipër të likuidojë kontraktorin brenda një periudhe 13 vjeçare. Kontraktori do të marrë përsipër të ndërtojë rrugën në fillim me shpenzimet e tij dhe mirëmbajtjen e kësaj rruge gjatë gjithë periudhës së koncesionit", theksoi Gjikhuri. Duke sqaruar se kjo është eksperiencia e parë e firmosjes së një kontrate të tillë, ministri Gjikhuri sqaroi se do të vazhdohet edhe me projektet e tjera të mëtejshme të Partneritetit Publik-Privat. "Siç tashmë publiku është i njohur, kemi disa projekte, të cilat ne gjatë këtij viti do ti tenderojmë, do t'i negociojmë,



Firmosja e kontratës për ndërtimin e Rrugës së Arbrit

Xhepa: Rruga e Arbrit mund të sjellë devijim të trafikut nga Selaniku drejt Durrësit

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Selami Xhepa thotë se fizibiliteti i një rruge nuk mund të bëhet paraprakisht. Duke folur për rrugën e Arbrit, marrëveshja për të cilën u firmos dje, ai thotë se kjo rrugë e kalon rëndësinë e ekonomisë kombëtare dhe vetëm pas ndërtimit të saj do të shikohet se çfarë do të ketë. I ftuar në "Para e Pasuri" në Ora News, Xhepa tha se përtej Rrugës së Arbrit, Shqipëria ka edhe shumë prioritetet e tjera dhe se qeveria duhet të përzgjedhë ato më të rëndësishmet. Xhepa: Rruga e Arbrit është një projekt që ka vlerat e veta dhe nga pikë-



pamja e rëndësisë e kalon rëndësinë e ekonomisë kombëtare. Kur bën rrugë të tjera është e vështirë të bësh fizibilitetin. Askush nuk mund të imagjinojë sot se sa pjesë të trafikut do të kanalizohet nga Maqedonia dhe do të zhvendosen nga porti i Selanikut për të ardhur në portin e Durrësit. Edhe në rastin

e rrugës Durrës-Kukës ish-të vështirë për të bërë një parashikim, por ne sot shikojmë që efekti i asaj rruge ka qenë me rëndësi të jashtëzakonshme për ekonominë. Përtej Rrugës së Arbrit, Shqipëria ka edhe shumë prioritetet e tjera. Mënyra se si zgjidhen projektet është thelbësore. Aeroporti i Vlorës mund të jetë shumë i dobishëm, por a është më fizibël të ndërtohet atë aeroport apo një rrugë. Problemi që ka qeveria është me transparencën me të cilën shoqëron projektet prioritare. Për sa i përket Rrugës së Arbrit ky është premtim që nga fillimi i tranzicionit.

do t'i kontraktuojmë dhe jam i bindur që viti 2019, 2020, 2021 do jenë vite të kantierëve të mëdha të ndërtimit. Unë i uroj shumë suksese

kompanisë dhe jam i bindur se do kemi një projekt të suksesshëm dhe së bashku do shikojmë tek qytetarët dibranë për t'u dhënë lajmin e

mirë", nënvizoi Gjikhuri. Ndërkaq, presidenti i "Gjoka Konstruksion" garantoj se kompania do të zbatojë me rigorizitet angazhimet e

Projekti për ndërtimin e rrugës

Rruga e Arbrit ka një gjurmë të drejtpërdrejtë Tiranë-Dibër dhe ajo kalon në Tiranë, Shkalla e Tujanit, Qafë-Murrizë, Guri i Bardhë, Ura e Vashës, Plani i Bardhë, Bulqizë, Dibër; Gjurma e Rrugës së Arbrit sipas propozimit do të jetë: Tiranë-Bulqizë 50 km dhe Tiranë-Bllatë 74 km; Rruga e Arbrit fillon në periferi të pjesë verilindore të qytetit të Tiranës dhe me 1.15 km ndjek një gjurmë të re deri te Ura e Brrarit, nga Ura e Brrarit deri në Zall-Bastar me një gjatësi 5.2 km, parashikohet plotësimi dhe përfundimi i punimeve; Nga Zall-Bastari te Ura e Vashës është segmenti më i rëndësishëm rreth 22.9 km, më i gjati si segment që kalon në një territor të vështirë nga ana topografike. Në këtë segment parashikohet të ndërtohen edhe veprat më të mëdha të artit. Parashikohet të ndërtohen Tuneli i Murrizit me një gjatësi 3.25 km dhe dy ura të mëdha, ura në fshatin Fshat dhe ura në dalje të Urës së Vashës; Në këtë pikë lidhet me Klosin me një segment 3 km, e cila do të lidhë qendrën e banimit të Klosit dhe rrethinat përreth me Rrugën e Arbrit. Më pas nga Ura e Vashës deri në Bulqizë me një gjatësi rreth 9.6 km do të vazhdojë plotësimi dhe përfundimi i të gjitha punimeve të nisura dhe i Tunelit të Bulqizës; Nga Bulqiza deri te Ura e Cerencit 20.2 km, rruga përshkohet në segment nga investimet; Nga Ura Cerencit në Bllatë 9.11 km, kemi një gjurmë të re rruge; Nga Bllata lidhemi me pikën kufitare më të afërt me Maqedoninë me gjatësi 600 metër dhe me Maqellarën prej 2,4 km.



do t'i kontraktuojmë dhe jam i bindur që viti 2019, 2020, 2021 do jenë vite të kantierëve të mëdha të ndërtimit. Unë i uroj shumë suksese kompanisë dhe jam i bindur se do kemi një projekt të suksesshëm dhe së bashku do shikojmë tek qytetarët dibranë për t'u dhënë lajmin e mirë", nënvizoi Gjikhuri. Ndërkaq, presidenti i "Gjoka Konstruksion" garantoj se kompania do të zbatojë me rigorizitet angazhimet e marra përsipër në këtë kontratë koncesioni. "Falënderoj qeverinë dhe ministrin për besimin. Më në fund duket që qeveria ka filluar të besojë tek kompanitë shqiptare. Premtoj që nuk do të zhgënjë, do ta realizojmë në cilësi dhe në afat", u shpreh Gjoka.

Mbështetje për vreshtarinë

Peleshi: Nga 300 mijë lekë, deri në 2 mln euro

Nga programi IPARD II dhe nga Skema kombëtare financiare është parashikuar edhe një grant për vreshtarinë, për mbjellje të re apo zgjerim vreshti, si dhe ngritje kantine. Ministri i Bujqësisë Niko Peleshi gjatë vizitës të një fermë me vreshta në Mamurras deklaroi se nga skema kombëtare financiare ka një hapësirë shumë të madhe për financime në sektorin bujqësor dhe agropërpunues. Peleshi tha se kjo hapësirë

zgjerohet shumë më tej, me programin IPARD II, çelja e thirrjes së parë do të bëhet në pranverë. "IPARD-i jep deri në 400 mijë euro për investime në fermë dhe deri në 2 milionë euro për investime në agropërpunim. Për vreshtarinë, sipas Skemës Kombëtare të Mbështetjes financiare është parashikuar për mbjellje vreshti (mbjellje të reja), me kultivarë për rrush tavoline 300.000 lekë për hektarë dhe për vreshtat me kultivarë autokton 350.000 lekë për hektarë. Për vadijen

me pika 2 milionë për hektar. Për investime në fermë, ngritje kantine, pra për të bërë ciklin e mbyllur të vreshtarisë dhe të verës, hapësira të të financuar me grant është deri në 2 milionë euro nga IPARD-i dhe deri në 200 milion lekë nga skema kombëtare", tha ministri. Ndërkohë, një risi e skemës kombëtare nga AZHBR-ja është dhe certifikimi. Kjo masë do të aplikohet për herë të parë në skemën kombëtare. "Mbështetja e certifikimit të standardeve të produkteve

mirë", nënvizoi Gjikhuri. Ndërkaq, presidenti i "Gjoka Konstruksion" garantoj se kompania do të zbatojë me rigorizitet angazhimet e marra përsipër në këtë kontratë koncesioni. "Falënderoj qeverinë dhe ministrin për besimin. Më në fund duket që qeveria ka filluar të besojë tek kompanitë shqiptare. Premtoj që nuk do të zhgënjë, do ta realizojmë në cilësi dhe në afat", u shpreh Gjoka.



Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi, gjatë vizitës në një fermë në Mamurras

dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për eksport, mbështetjet dhe nga Programi IPARD, i cili i ka dhënë një prioritet të veçantë. Marrja e certifikatave ndërkombëtare, si ASAP, Global Gap etj., do t'u hapë dyert produkteve vendase, për zgjerim të tregut dhe eksporteve, duke i drejtuar ato

drejt supermarketeve dhe tregjeve evropiane, të cilat kanë kërkesa dhe standarde të larta. Viti 2017 mund të quhet një vit shumë i suksesshëm për bujqësinë shqiptare, pasi pati rritje prej 19,9% të eksporteve të produkteve vendase" bëri të ditur Peleshi.

Ankohen pacientët, cilësia e dobët e shërbimeve, financimi i ulët i sistemit

KLSH kryqëzon qeverinë për shëndetësinë, mungojnë shërbimet

Rriten kostot e shërbimeve në mungesë të protokolleve të miratuara

Ornela Manjani

Procedurat e zgjatura dhe me shumë halka në sistemin e referimit për pacientët, pakënaqësia e pacientëve për cilësinë e dobët të shërbimeve shëndetësore, financimi i ulët i sistemit shëndetësor, rritja e kostove të shërbimeve në mungesë të protokolleve të miratuara, etj., përbëjnë problemet kryesore dhe tregojnë performancën e ulët të sistemit shëndetësor, janë problemet kryesore të sistemit shëndetësor të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në një raport të publikuar nga KLSH për kostimin e shërbimeve shëndetësore dalin në pah problemet që ka sistemi shëndetësor në vend. Në raport radhiten të gjithë problemet që nga mungesa e shërbimeve, shërbimi i dobët, mosfinancimi i spitaleve dhe deri të mungesa e mjekëve specialistë. "Sistemi aktual i vlerësimit të kostove për shërbimet spitalore është një vlerësim që mbart shpenzime të tepërta dhe nuk reflekton kostot e vërteta, duke orientuar kërkesat e institucioneve shëndetësore spitalore drejt vlerësimit të shpenzimeve dhe jo sipas kostove të tyre. Mungesa e specialiteteve pranë shërbimeve në spitalet rajonale dhe bashkiake, si dhe mungesa e performancës së shërbimit parësor ka krijuar rritjen e kostove dhe përqendrimin e pacientëve në qendrat më të madhe universitare QSUT" thuhet në raportin e Kontrollit të Lartë të shtetit.

PAKETAT SHËNDETËSORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se implementimi i paketave shëndetësore përbën një nisim të mirë për miratimin e protokolleve për këto paketa, por mënyra e vlerësimit financiar të tyre bie nënesh me ligjin e prokurimeve publike, duke rritur kostot e këtyre shërbimeve shëndetësore. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, së bashku me Fondin edhe QSUT, të angazhohen në hartimin dhe implementimin e protokolleve klinike për të gjitha shërbimet spitalore duke pasur si orientim modelin DRG dhe klasifikimin

VENDIM

Nr. 204 , Datë 29 / 12 / 2017

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "KOSTIMI I SHËRBIMEVE SPITALORE"

Në zbatim të planit vjetor 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAT etj.), sipas programit të auditimit Nr. 637/6 Prot., dt. 06/10/2017, realizoi auditimin me temë "Kostimi i shërbimeve spitalore". Subjekt i këtij auditimi janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor; Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"; Spitali Rajonal Vlorë dhe Spitali Rajonal Shkodër. Faza e terrenit të auditimit nisi në dt. 09.10.2017 me programin e auditimit Nr. 637/6 Prot., dt. 06/10/2017.

Faksimile e raportit të KLSH-së

më të fundit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10. Riorganizimi i hartës së spitaleve mbi bazën e treguesve të performancës së shërbimit spitalor përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për uljen e kostove të tepërta për sistemin shëndetësor. Premisat e krijimit të një tregu shëndetësor do të çonte në ekuilibrin e kërkesë - ofertës duke rritur eficientë cilësinë e shërbimeve nga ofruesit e kujdes-

it shëndetësor për pacientët" thuhet në raport. Sipas KLSH-së mungesa e protokolleve klinike të përshatshme sipas praktikave më të mira reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e ulët të kujdesit shëndetësor parësor dhe rritjen e kostove financiare të këtyre shërbimeve. **AKREDITIMI** Gjithashtu, dhe mungesa e akreditimit të spitaleve publike dhe jopublike, ka

ndikuar në mungesën e sigurimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor, sipas standardeve të kërkuara. "Protokollet klinike dhe procedurat standarde të punës nuk janë miratuar akoma zyrtarisht në spitalet rajonale dhe universitare, duke ndikuar ndjeshëm në keqpërdorimin dhe abuzimin me furnizimin dhe përdorimin me barna dhe materiale mjekësore. Hartimi korrekt e shkencor dhe zbatimi

PROBLEMET E KONSTATUARA NGA KLSH

1. Ndryshimi i protokolleve dhe procedurave klinike të reflektuara në VKM-së; tregon që protokollet dhe procedurat klinike të paketave të shërbimeve shëndetësore të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk janë aplikuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, kryesisht; a) për paketën e kardiokirurgjisë ku ka ndryshuar koha e qëndrimit mbas interventit; b) për paketën e implantit koklear, e cila rezultojnë jo efektive pasi nuk është realizuar asnjë intervent si nga institucionet shëndetësore publike dhe jo publike. Të gjitha paketat shëndetësore që financohen nga FSDKSH mbas ndryshimeve të fundit të VKM nr. 308, kanë rritje të çmimit.
2. Përcaktimi i kostove për paketën shëndetësore nga këshilli administrativ i Fondit është në kundërshtim me përcaktimin e nenit 10 të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" dhe Nenin 18 të Statutit 21 të FSDKSH.
3. Përcaktimi i kostove nga këshilli teknik për hartimin e paketave duke marrë për bazë kostot direkte si kosto indirekte të QSUT nuk mund të shërbejnë si kosto referencë për institucionet shëndetësore jopublike.
4. FSDKSH nuk ka ngritur komision për rishikimin e çmimeve të paketave për shërbimet shëndetësore sipas përcaktimit të pikës 8 në VKM nr. 308 datë 12.05.2014 "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor"
5. Përcaktimi i marzhit të fitimit për paketat shëndetësore nga këshilli teknik është arbitrar dhe jo i përcaktuar sipas ndonjë studimi të mirëfillt të analizimit të kostove dhe përcaktimeve ligjore për vendosjen e tij.
6. Mos realizimi i paketës së implantit koklear tregon ineffektivitetin e procesit të propozimit, hartimit dhe miratimit të paketave shëndetësore nga Këshilli Administrativ i FSDKSH.

mi i protokolleve të mjekimit e procedurave standarde të punës është hap i domosdoshëm në rritjen e transparencës, verifikueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, me qëllim final rritjen dhe përmirësimin gradual të cilësisë së shërbimit spitalor" thuhet në raport. Sipas KLSH-së, Protokollet e mjekimit dhe procedurat standarde të punës

nuk ekzistojnë akoma zyrtarisht në shërbimet spitalore duke rritur ndjeshëm keqpërdorimin dhe abuzimin në barna dhe materiale mjekësore si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive të stafit mjekësor për trajtimin e pacientëve jo sipas protokolleve klinike të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tregtia e lirë bashkon prodhuesit nga Shqipëria dhe Kosova

Ultimatum drejtuar dy qeverive, në të kundërt protesta në dogana

Prodhuesit nga Shqipëria dhe Kosova janë mbledhur të hënën në Prishtinë për të nënshkruar kërkesat specifike drejtuar qeverive të dy vendeve. Objektivi kryesor i sipërmarrjes kombëtare është heqja e barrierave tarifore dhe jotarifore për qarkullimin e lirë tregtar dhe ekonomik mes Shqipërisë dhe Kosovës. Dokumenti është nënshkruar nga "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë" dhe "Klubi i Prodhuesve të Kosovës" me mbështetjen e "Forumit Ekonomik të Prodhuesve Kombëtar Shqiptarë". Në total janë 10 kërkesa, të grupuara në dy hapa, ku për hapin e parë qeverive u vendoset një ultimatum kohor për përbushjen e tyre, në të kundërt grupet e prodhuesve paralajmërojnë se do të përshkallëzohet me protesta në të gjitha pikat

doganore. Kërkesa e parë është heqjen e pagesës për skanerin në Republikën e Shqipërisë për të gjithë qarkullimin tregtar import-eksport, Shqipëri-Kosovë; (Kërkesa i drejtohet qeverisë së Shqipërisë, afati i përbushjes së kësaj kërkesë 30 maj 2018) dhe më pas heqja e pagesës për terminalin doganor në Republikën e Kosovës për të gjithë qarkullimin tregtar import-eksport, Shqipëri-Kosovë dhe Kosovë-Shqipëri; (Kërkesa i drejtohet qeverisë së Kosovës, afati i përbushjes së kësaj kërkesë 30 prill 2018). Në listën e kërkesave është njoftja e certifikimeve dhe analizave fitosanitare të të gjithë produkteve që i nënshtrohen këtyre analizave dhe certifikatave; (Kërkesa i drejtohet të dy qeverive, afati i përbushjes së kësaj kërkesë 30 mars 2018). Të tjera kërkesa janë: Thjeshtimi i procedurave për eksporti-



min e produkteve farmaceutike për sipërmarrësit e Kosovës dhe Shqipërisë; (Kërkesa i drejtohet të dy qeverive, afati i përbushjes së kësaj kërkesë 30 mars 2018), përshpejtimi i procedurave doganore, në trajtimin e praktikave të qarkullimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet dy shteteve. (Kërkesa i drejtohet të dy qeverive, afati i përbushjes së kësaj kërkesë 30 prill 2018) dhe kërkesa për rishikimin e kufirit për akcizën e birrës. Aktualisht është 200.000 hektolitër. Në mënyrë që konkurrenca të jetë në favor të të gjithë sipërmarrësve kërkohet që kufiri të vendoset: a) ose të ulët në 50.000 hektolitër; b) ose të ngrihet në 500.000 hektolitër.

Tatimet: 12 shkurti afati i fundit për Tatimin e Thjeshtuar

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, ju kujton se data 12 shkurt 2018, është afati i fundit për dorëzimin e deklaratës vjetore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, për periudhën tatimore të lidhur me vitin kalendarak 2017. Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar kjo deklaratë vjetore duhet të dorëzohet nga çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzime të ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Nderkohë deklaratën duhet ta dorëzojnë të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë. Këta tatimpagues dhe plotësojnë këtë deklaratë sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave. Administrata tatimore ju këshillon të plotësoni korrektësisht dhe në afat këtë deklaratë vjetore për të shmangur penalitetet administrative parashikuar ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për informacion dhe asistencë lidhur me plotësimin dhe dorëzimin e kësaj deklarate mund t'i drejtoheni sporteleve të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në të gjithë vendin ose të telefononi në numrin pa pagesë të Qendrës së Thirrjeve 0800 00 02.



Dëshmia e babait të Elton Halipajt: I ofrova punë kopshtar pranë minibashkisë, e refuzoi

Ina Allkanjari

TIRANE

Vrasja e Devi Kasmit, lihet në burg special grek dhe 3 bashkëpunëtorët

Efthymious ofron garanci 10 mijë euro për të fituar lirinë

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg", për katër të arrestuarit si të dyshuar për vrasjen e Devi Kasmit në kryeqytet, mbas ditën e 29 janarit. Përpara trupës gjyqësore ka dalë shtetasi grek Efthymious Efthymious 41-vjeçar, i dyshuar si ekzekutori i Kasmit, Elton Halipaj, personi, i cili dyshohet se siguroi mjetet për vrasjen; Malvin Dinellari mendohet se siguroi infrastrukturën dhe Elton Hoxhallari, i cili dyshohet të jetë bashkëpunëtor në vrasje. Vazhdon të jetë në kërkim Aurel Hoxhallari, i cili mendohet të jetë organizatori i krimit. Prokuroria kërkoi masën e arrestit me burg për katër të arrestuarit si pjesë të grupit kriminal, kërkesë e cila u pranua nga Gjykata e Krimeve të Rënda.

SEANCA GJYQËSORE

Në seancën e djeshme gjyqësore kundër grupit të strukturuar kriminal të arrestuar për organizimin dhe vrasjen e Devi Kasmit rreth një javë më parë, janë dëgjuar dëshmi të ndryshme dhe kanë dalë të tjera detaje në lidhje me këtë ngjarje. Katër të arrestuarit kanë mohuar akuzat dhe kërkuar lirinë nga trupi gjyqësor, por kjo nuk e ka bindur gjykatën.

Mësohet se 41-vjeçari grek ka pajtuar si avokat mbrojtës Saimir Vishën, por që nga momenti i arrestimit në datën 2 shkurt, ai ka mohuar të ketë lidhje me ngjarjen. Përmes avokatit mbrojtës, ish-speciali grek ka ofruar një garanci pasurore prej 10 mijë eurosh për të fituar lirinë, por kjo u rrefuzua nga gjykata. Avokati Visha ka pretenduar se klienti i tij ndodhet në Shqipëri si turist dhe ka hyrë në mënyrë të rregullt në vendin tonë. Ndërkohë mësohet se për Efthymious do të vijë një avokate greke, e cila do të përfaqësojë në këtë çështje. Më herët në dëshminë e tij para uniformave blu, 41-vjeçari grek ka pranuar se ka njohe me njërin nga të akuzuarit për ngjarjen, shtetasin Aurel Hoxhallari. "Aurelin e njoh që kur ishte emigrant në Greqi. Kam ardhur disa herë në Shqipëri dhe e kam takuar. Kam qëndruar disa herë tek vila e Aurelit në Mëzëz, por qëndroja edhe në shtëpinë time që kam marrë me qira", ka dëshmuar Efthymious Efthymious. Por pavarësisht kësaj njohje, ai këmbëngul se nuk ka lidhje me vrasjen dhe viktimitin.



Ish-speciali grek, Efthymious Efthymious

MASA E ARRESTIT ME BURG

- **EFTHYMIU EFTHYMIOS,**
41 vjeç, lindur e banues Arta Greqi
- **ELTON HALIPAJ,**
36 vjeç, lindur në Skrapar e banues në Tiranë
- **MALVIN DINELLARI,**
30 vjeç, lindur në Korçë e banues në Tiranë
- **ELTON HOXHALLARI,**
36 vjeç, lindur e banues në Tiranë

Vrasësi i Kasmit, roje në ambasadën shqiptare në Athinë

E shkuara e grekut Efthymious, avokati Sakis Kehajoglou: Ja akuzat dhe dënimet e ish-specialit



Avokati Sakis Kehajoglou

Zbardhen të tjera detaje për të shkuarën kriminale të shtetasit grek Efthymious Efthymious, i cili akuzohet se është ekzekutori i Devi Kasmit. "Zougla.gr" shkruan se 42-vjeçari, ish-agjenti special grek, Efthymious ka shërbyer si roje në ambasadën shqiptare në Athinë, si edhe për mbrojtjen e objekteve publike në sheshin "Sintagma". Mësohet se greku në vitin 2008 është arrestuar për trafik klandestinesh drejt Greqisë. Ndërkohë në vitin 2009 në Frankfurt u kap me 5.5 kg kokainë që vinte nga Venezuela. Media greke raporton se Efthymious u lirua nga policia në vitin 2012. Por duket se aktivitetet kriminale të grekut vijojnë, pasi ish-speciali u arrestua në 2016 në Artë për trafik droge dhe dënohet në burg 10 muaj. Në gjyqin që u bë në 2017 në Janinë, ranë akuzat se bëhej fjalë për një grup kriminal, dhe të pandehurit e tjerë u shpallën të pafajshëm përveç Efthymious, i cili u dënua si përdorues droge, kokainë. Ai mori një dënim prej 4 vitesh me kusht, ndaj dhe u lirua. "Zougla.gr" shkruan se...

an mes të tjerash se avokati i mirënjohur grek Sakis Kehajoglou, i cili e ka mbrojtur Efthymious në çështjet e mëparshme në Greqi mban kontakte me avokatët në Tiranë që përfaqësojnë 42-vjeçarin. Ndërkohë edhe avokati i tij Sakis Kehajoglou, i njohur gjithashtu si avokati i Alket Rizait, ka folur në Top Channel për të kaluarën e shtetasit grek, që tashmë akuzohet për vrasjen e Devi Kasmit. "Efthymious Efthymious ishte klienti im. Çështja kryesore

për të cilën është akuzuar parvjet në Greqi ishte për pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe trafik kokainë në qytetin e Artës. U burgos për disa muaj bashkë me shtetas të tjerë grekë, sepse gjithsej u akuzuan 30 vetë. Por, në një gjykatë të shkallës së dytë, vjet në Janinë, të gjithë dolën të pafajshëm, ndërsa Efthymious Efthymious u dënua si përdorues droge për trafik lëndësh narkotike me 4 vite burg me kusht dhe u la i lirë",-tha Sakis Kehajoglou,

ish-avokati i Eythimios Eythimious. Pasi ka përshkruar edhe gjendjen e tij familjare, juristi i njohur grek pohon se, prej kësaj periudhe ai ka humbur kontaktet me klientin e tij, por vlerëson se mbrojtja e tij në Shqipëri do të bëhet në bazë të faktëve dhe provave që disponon policia dhe gjykata. "Efthymios Eythimious ishte pjesëtar i forcave policore greke, por është përjashtuar për shkelje të rënda ligjore nga trupa e policisë. Është akuzuar për shumë shkelje ligji në të kaluarën, për disa është dënua dhe për disa ka dalë i pafajshëm. Është me origjin nga Arta, nëna e tij ka vdekur, kurse babai i tij vuan nga një sëmundje e rëndë",-tha më tej Sakis Kehajoglou. Në bisedën që Kehajoglou ka bërë me avokatit shqiptar të Eythimios Eythimious, ky i fundit i ka thënë se klienti i tij këmbëngul që është i pafajshëm.

Mes dëshmiave, në seancën gjyqësore është regjistruar edhe ajo e babait të Elton Halipajt, personi që akuzohet se siguroi mjetet për vrasjen e

Devi Kasmit. Hyda Halipaj, nënkryetari i shoqatës së pensionistëve, tha se pak kohë më parë i kishte siguruar të birit një punë si kop-

shtar pranë njëres prej minibashkive në kryeqytet, por se e kishte refuzuar: "Më tha që nuk dua ta bëj atë punë, se kam gjetur një tjetër",- tregoi

i moshuari. Sakaq edhe nëntari i grupit të organizuar kriminal, Elton Hoxhallari, nuk ka pranuar akuzën e ngritur ndaj tij për "Vrasje

me paramendim". Hoxhallari nuk ka pranuar të ketë bashkëpunuar me bandën kriminale për ekzekutimin e Devi Kasmit, duke kërkuar rrëzimin akuzës së ngritur ndaj tij. Me herët, gjykata e Tiranës caktoi masën e arrestit me burg për Mario Meshinin, i dyshuar në rolin e bashkëpunëtorit. Kujtojmë se ishte dëshmia e Mario Meshinit, ajo që hodhi dritë mbi identifikimin e autorit të krimit që tronditi kryeqytetin mbasditën e 29 janarit.

ARRESTIMET

Devi Kasmi u ekzekutua me 4 plumba mbrëmjen e 29 janarit në rrugën 'Kongresi i Manastirit' në afërsi të Urgjencës së Peditrisë. Atentatorët thuhet se pritën deri sa objektivi i tyre doli nga banesa, ndërsa qëlluan ndaj tij, duke e lënë të vdekur në vend. Fill pas krimit ata u larguan me shpejtësi në drejtim të SHISH. Policia në bashkëpunim të ngushtë me prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, finalizuan me sukses dhe në kohë rekord goditjen e grupit kriminal, të cilët dyshohen se organizuan vrasjen dhe ekzekutuan shtetasin Devi Kasmi. Uniformat blu vunë në pranë Efthymious Efthymious, 41 vjeç, lindur e banues Arta Greqi; Elton Halipaj, 36 vjeç, lindur në Skrapar e banues në Tiranë; Malvin Dinellari, 30 vjeç, lindur në Korçë e banues në Tiranë; Elton Hoxhallari, 36 vjeç, lindur e banues në Tiranë. Gjithashtu u shpall në kërkim shtetasi (Altin) Aurel Hoxhallari, 41 vjeç, lindur e banues Tiranë. Shtetasi i shpallur në kërkim (Altin) Aurel Hoxhallari, dyshohet si organizatori i këtij grupi të strukturuar kriminal. Shtetasi Elton Halipaj ka siguruar mjetet e nevojshme për kryerjen e krimit. Shtetasi grek Efthymious Efthymious, dyshohet në rolin e ekzekutorit të shtetasit Devi Kasmi. Në momentin e arrestimit, atij u gjetën me vete një sasi prej 25 mijë eurosh, që dyshohet se i ka përfutur si shpërblim për vrasjen. Shtetasi Malvin Dinellari ka siguruar mjetet dhe përgatitur infrastrukturën për realizimin e vrasjes. Shtetasi Elton Hoxhallari dyshohet si bashkëpunuar në sigurimin e mjeteve dhe përgatitjen e infrastrukturës për realizimin e vrasjes. Gjatë këtij operacioni të mirë-organizuar janë ushtruar kontrolle në disa banesa të autorëve të dyshuar si dhe në një vilë të ndodhur në periferi të Tiranës, në pronësi të organizatorit të këtij grupi, Aurel Hoxhallari, e cila shërbente si bazë e grupit.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartes Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shitenj e pasurise te paluajtshme Truall me Nr. pasurie.6/286 dhe sip.108.24 m², Zona Kadastrale Nr.8513, Vol.24, Fq.102 e ndodhur ne Rr"V.Kuqi", Lagjia 12, Durrës me vliere fillestare ne ankand 67.200 EURO .
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartes Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shitenj e pasurise te paluajtshme Nderetesë me Nr. pasurie.6/56 dhe sip.108.24 m², Zona Kadastrale Nr.8513,vol.31,fq.121 e ndodhur ne Rr"V.Kuqi",Lagjia 12, Durrës me vliere fillestare ne ankand 1.120 EURO .
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartes Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 02.03.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitenj e pasurise te paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1000 m², numër pasurie 294/33, Zona Kadastrale 3339, Volumi 11, Faqe 208 e ndodhur në Virmë, Durrës në pronësi të Z.Ardian Rexhep Kola me vliere fillestare ne ankand 1.764.000 LEKE.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

TIRANE - Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka propozuar emrin e Ardi Veliaj të drejtor të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili deri dje ka mbajtur detyrën e drejtorit të Policisë së Tiranës. Mësohet se propozimi është firmosur nga kryeministri Edi Rama. Ardi Veliu kalon në detyrën e kryepolicit Haki Çakon, i cili u lirua një muaj më parë me vendim të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në ceremoninë e betimit të drejtorit të ri të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu falënderoi qeverinë për besimin që i ka

Rama firmos propozimin e Xhafajt

Ardi Veliu emërohet drejtor i përgjithshëm i Policisë Shtetit

ngarkuar dhe nuk e fshehu se ky post ka qenë ëndrra e tij. Veliu tha se edhe pse policia është institucioni më i besuar nga qytetarët, ka nevojë për një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore, që duket se do të jetë edhe sfida e tij. "Sot më është besuar detyra e rëndësishme e drejtorit të përgjithshëm të

Policisë së Shtetit. Çdo oficer policie e ëndërron këtë ditë dhe nuk dua ta fsheh, e kam menduar edhe unë, por sot e shoh si sfidën e jetës sime. Unë e di që nuk jam vetëm në realizimin e këtij misioni dhe jam i ndërgjegjshëm se organizata e policisë është institucioni më i besuar nga publiku në Shqipëri. Policia e

Shtetit sot ka nevojë për një menaxhim më eficient të burimeve njerëzore. Do të vlerësohet punonjësi i policisë që është më i përkushtuar", - tha Veliu, i cili zëvendëson Haki Çakon në këtë detyrë. Ardi Veliu mori pikët maksimale nga konkursi i organizuar nga Policia e Shtetit për marrjen e gradës "Drejtues Mad-



Ardi Veliaj, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

hor", si dhe ka përbushur të gjitha kriteret për të qenë drejtor i policisë. Ai ishte ndër emrat më të lakuar për

të zëvendësuar Haki Çakon. Ndërkohë, pritet që Veliu të emërohet edhe drejtorin e ri të Policisë së Tiranës.

Gjinkuri depozitoi 2 kallëzime pranë organit të akuzës: Dëm prej 54 mln dollarësh ndaj shtetit

Rruga Tiranë-Elbasan, prokuroria: Hetim ish-ministrit Haxhinasto

Tre ish-zyrtarë, nën arrest për shpërdorim detyre

TIRANE

Vijojnë hetimet për dosjen e abuzimeve me rrugët pas prangosjes së ish-drejtorit të 'Rrugëve', Dashamir Xhika dhe prerjes së dy fletarresteve të tjera për Aksel Qurduduk dhe Alben Alitën, ish-drejtues në Njësinë e Menaxhimit të projektit Tiranë-Elbasan. Bëhet me dije se në lidhje me këtë çështje është nën hetim edhe ish-ministri Edmond Haxhinasto, i cili ka mbajtur postin e ministrit të Transporteve për tri vite radhazi. Haxhinasto po hetohet për abuzimet me rrugën Tiranë-Elbasan, e cila edhe pse ka nisur të ndërtohet që në vitin 2011, ende nuk ka përfunduar - deklaroi "Report TV". Ai u emërua ministër i Transporteve në shtator të 2013-ës, ndërsa dha dorëheqjen në shtator të 2016-ës dhe në vend të tij u emërua Sokol Dervishaj.

MASAT E ARRESTIT

Për dosjen e abuzimeve me rrugët, krimet e Rënda kanë shjerrë 3 masa arresti për ish-drejtorin e 'Rrugëve', Dashamir Xhika dhe Alben Alitë e Aksel Qurduka, të cilët kanë qenë ish-drejtorë të Njësisë së Menaxhimit të projektit Tiranë-Elbasan. Personat e sipërpërmendur dyshohen për korrupsion dhe shpërdorim detyre me fondet dhe projektet për rrugën Tiranë-



Ish-ministri i Transportit dhe Infrastrukturas, Edmond Haxhinasto

Elbasan, me një dëm që prokuroria e përlogarit në 80 milionë euro. Komunikimi i urdhrit të lëshuar për Dashamir Xhikën nga prokurorja e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj është bërë dy ditë më parë në

ambientet e policisë së Elbasanit, ku Xhika qëndron i arrestuar për një çështje tjetër. Për Dashamir Xhikën, në të njëjtën ditë Gjykata e Elbasanit konfirmoi një tjetër masë sigurie me burg, për dosjen e rrugës Elbasan-

Gjinari, ku përlogarit në dëm në buxhetin e shtetit prej 5.3 miliardë lekë. Për rrugën Tiranë-Elbasan janë depozituar dy kallëzime në prokurori, më i fundit i dorëzuar nga ministri Damian Gjinkuri më 12 dhjetor 2017. Kallëzimi i ministrit Gjinkuri erdhi pas një auditi të kryer pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, ku sipas tij është konstatuar një dëm prej 54 milionë dollarësh ndaj shtetit mbi zbatimin e kontratave për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan. Ndërkohë, prokurorët janë duke shqyrtuar çështjen e rrugës së Gjinarit dhe atë Tiranë-Elbasan në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Tre ish-zyrtarët akuzohen për "Shpërdorim detyre".

Pronat e Balilit, Apeli i Krimeve të Rënda lë në fuqi sekuestron

Apeli i Krimeve të Rënda ka lënë në fuqi ditën e djeshme sekuestron e pronave të familjes së Klement Balilit në Sarandë. Mes pronave të sekuestruara është edhe resorti luksoz "Santa Quaranta", disa apartamente, troje dhe dyqane në pronësi të të afërmeve të Balilit. Sekuestro e pronave u vendos nga prokuroria pas akuzave ndaj Klement Balilit, ish-kreut të transporteve në Sarandë, si i dyshuar për trafik ndërkombëtar narkotikësh. Gjykata e Krimeve të Rënda vendosi në nëntor të 2017-ës sekuestron preventive për mostjetësimin e "Santa Quarantas". Klement Balili është person në kërkim për llogari të drejtësisë greke dhe asaj shqiptare dhe i dyshuar si personi që drejton një grup kriminal të trafikut të drogës në Ballkan drejt Europës. Vetë ai e mohoi këtë akuzë në të vetmen dalje publike pak ditë pas urdhër-arrestit grek dhe nga ajo ditë është zhdukur, duke iu fshehur policisë. Donald Lu e cilësoi Balilin ironikisht "magjistar", pasi ka mundur t'i shmangte arrestimit për gjithë këtë periudhë.

MD: Procedim disiplinor punonjësve

Vetingu në burgje, zbulohen 130 punonjës me dënime penale

Verifikimet e kryera për pastërtinë e figurës së policëve të burgjeve (vetingu), rezultoi se 130 prej tyre kanë dënime penale. "Ashtu siç është paralajmëruar nga Ministria e Drejtësisë për verifikimin e pastërtisë së figurës së policëve të burgjeve (vetingu) në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve po kryen verifikimin e të dhënave penale të të dënuarve të raportuar nga regjistrat i gjendjes gjyqësore për të gjithë punonjësit e policisë gjyqësore, në të gjitha nivelet. Ky veri-

fikim bazohet në Nenin 17 pika 1/d i Ligjit nr. 10032 "Për Policinë e Burgjeve", ku shprehimisht thuhet se një nga kriteret e përgjithshme për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve është që personi të "mos jetë dënuar penalisht me vendim gjykate të formës së prerë". Bazuar

në verifikimin e kryer nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, deri tani rezultoi që rreth 130 persona janë me dënime penale", - sqaron MD. Bëhet me dije se për këta persona do të nisë procedim disiplinor.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service" me permbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 26.02.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shijën e pasurisë të paluajshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m², me Nr pasurie 1/154+1-4, Vol.7, Fq.247 me vlerë filltare ne ankand 24.570 EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 350 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,384,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallil", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas datave të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 01 Mars 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

150 efektivë të FA në terren, shpëtohet e moshuara në Novoselë

Ndërpriten reshjet, përmirësohet situata në Fier dhe në Vlorë

Vjosa përmblyti 230 banesa e 3000 ha tokë

Ndërprerja e reshjeve të shiut ka çuar në përmirësimin e situatës në Fier dhe në Vlorë, ku si pasojë e vërshimit të ujërave të lumit Vjosa u përmbytën dhjetëra shtëpi e mijëra hektarë tokë. Dje lumi Vjosa është tërhequr në shtratin e tij, ndërsa ka rënë të ndjeshme të nivelit të ujërave në të gjithë pellgun Levan-Ura e Mifolit-Novoselë. Megjithatë, situata vijon të jetë e rënduar në fshatrat Fitore dhe Novoselë të Vlorës, ku rreth 80 banesa vijnë të jenë në pushtetin e ujit, i cili ka arritur deri në 2 metra në disa prej banesave. Ndërsa aksi Levan-Vlorë, si dhe rrugët që lidhin këto fshatra janë totalisht të bllokuar nga uji. Mësohet se në Novoselë të Vlorës është bërë evakuimi i dy banorëve, të cilët kanë



Përmblytjet në Vlorë

kërkuar ndihmë. Ndërsa, një grua e moshuar është gjetur pa ndjenja brenda banesës së saj në këtë fshat. Bëhet fjalë për 75-vjeçaren Bezgo Haxhiraj, e cila u gjet nga Delta Force, që po kryenin kontrollin për rastet emergjente në zonë e po ndihmojnë banorët e bllokuar

brenda shtëpive të tyre. E moshuara është dërguar me urgjencë drejt spitalit të Vlorës. Sipas të dhënave paraprake dyshohet se 75-vjeçarja ka pësuar infarkt dhe ka mbetur e bllokuar brenda banesës së saj si pasojë e përmblytjeve. Bilanci më i rëndë paraqitet për ban-

orët e Fierit, ku si pasojë e daljes së Vjosës nga shtrati u përmbytën 150 shtëpi si dhe rreth 3 mijë ha tokë bujqësore. "Situata është e njëjtë me përmblytjet e mëparshme. Jemi në hall, pasi sa herë bie shi, ne përmblytemi. Shteti i ka fajet, nuk e kemi nga Zoti. Duhet të ishim njoftuar për rrezikun që na kanoset nga reshjet, pasi kemi pësuar dëme të shumta", tha një banor nga fshati Ferras. Rruga kryesore nga ky fshat në hyrje të Levanit është e pakalueshme. E vetmja mundësi është linja hekurudhore. Ushtria me mjete lundruese dhe kamionë qëndron në gatishmëri. Mësohet se 150 efektivë të Forcave të Armatosura ndodhen në terren si në Levan, Ferras, Dar'ëzë dhe Novoselë, për t'u ardhur në ndihmë banorëve të përmblytur.



Pallati rrezikon shembjen, banorët futen në banesa: Shteti të na gjejë strehë

GJIROKASTËR - Banorët e pallatit 8-katësh në lagjen "Kodra e Shtufit", që rrezikon të shembet, mbremë kanë thyer vendimin e evakuimit të marrë dy ditë më parë, pas rreshqitjes së një masivi dheu që përfshiu 3 katet e para të ndërtesës. Ata kanë hyrë forcërisht në banesat e tyre, pa varësisht rrezikut që iu kanoset,

PETRO KOÇI

Zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, ka folur dje për situatën në Gjirokastrë. I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24", ai tha se situata ka qenë dramatike dhe e dëshpëruar për banorët, pasi rreshqitjet e dheut rrezikuan shembjen e një pallati. "Duhet të gjenden përgjegjësit në lidhje me lejen që është dhënë për ndërtimin e pallatit", tha Koçi.

Njëri ia hedh topin tjetrit. Prefekti na tha ikni poshtë se do i japin shtëpi me qira. Vajtëm poshtë, kryebashkiaku ka ngritur duart lart se nuk ka lekë të na japë as për qira e as për gjë. Po rrimë në ballë", u shpreh një tjetër banor.

bashkëpunimi german
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by **giz** German Development Cooperation

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services and "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. The realisation of the EU action "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM) delegated to GIZ aims at implementing the second component of "IPA 2016 - Support to Water Management" sector programme, which seeks to enhance the implementation of the National Water Reform and the progress of Albania towards EU water legislation requirements. The specific objective of the EUSWAM Action is to reduce pollution in Adriatic coastal water via strengthened capacities and operation and maintenance of waste water infrastructure along the coast and in particular in selected municipalities that have benefited from EU support for the development of their waste water management infrastructure.

The EU financed project forms part of the CPWS and focuses on 4 components:

1. Improvement of the performance and performance reporting of selected waste water utilities along the coast of Albania
2. Strengthening of the capacity of the new National Agency for Water Supply and Waste Water (AKUK) with a particular focus on the waste water sub-sector in line with its recently approved enhanced mandate and policies
3. The improvement of the operation and maintenance of existing coastal waste water treatment plants (WWTP)
4. The build-up of the awareness and participation of the stakeholders of the waste water sector on the importance of (a) advancing the fulfilment of EU water regulatory requirement especially toward the Urban Waste Water Treatment Directive (UWWTd) and (b) encouraging that water utilities delivering waste water related services (collection and treatment) are reasonably covering their costs to ensure sustainability of services in line with prevailing government policies in the sector

For the support of the GIZ programme team and for the component 2 (Strengthening the capacity of the National Agency for Water Supply and Waste Water (AKUK) with a particular focus on the waste water sub-sector, GIZ Office Albania is looking for a

ADVISOR - INSTITUTIONAL AND ORGANISATIONAL DEVELOPMENT

with special focus of strategic and infrastructure planning (project planning, budgeting, controlling, monitoring, reporting; staffing) in the water and sanitation sector.

A. Responsibilities
Enhancement of the GIZ programme team for the consultancy on national and municipal level, for the Ministry of Infrastructure and Energy and its subordinated agencies, the National Agency for Water and Waste water, the Water regulator, municipalities and their water utilities to improve drinking water supply and sanitation services. The advisory services for the National Agency for Water and Waste Water shall be rendered on organisational, financial and technical development in a participatory manner with the staff and close cooperation with the programme team members.

B. Tasks
The Institutional and Organisational Development Expert performs the following tasks participatory with the partners.

For the National Agency of Water and Waste Water (AKUK)

Organizational Development

- Evaluation of the existing structure and development of recommendations for restructuring of the organisation
- Development of job description and descriptions of function
- Facilitating and supporting a budgeted organisational plan for the agency prior overall agreement on functions and responsibilities of the institution.
- Coordination of a medium term action plan (incl. assessment of the planning and implementation of waste water infrastructure) to orient the management and the operation of WWTPs to the EU Urban Waste Water Treatment Directive (UWWTd).
- Adaptation of required institutional processes for the realizing of tasks and responsibilities.
- Development of Capacity Development plan for AKUK (management, financing, techniques, including On boarding, tasks, role and responsibility of AKUK, services)
- Training programme and/or information material for WUs: sense, purpose and benefit of KPIs, reporting, etc.

Waste Water Management

- Assist AKUK to support managers and technical staff of concerned operators in defining relevant organizational, technical and individual bottlenecks and constraints of the operation of waste water treatment plants.

Validity check and evaluation of WWTPs Performance Reporting

- Support AKUK staff in evaluating performance report and validity check of KPIs as basis for WWTP performance and related investments

Awareness

- Assisting AKUK in supporting municipalities and operators prior sensitizing them to further adapt and implement certain information and awareness raising events on the EU waste water principles in the region.
- Cooperation with EU Information Centres.

For the programme:

- Identification of needs for external support and advice for AKUK
- Follow-up of project progress and activities in close cooperation with the partners
- Contributing to and/or preparation of technical reports (internal/external) and to the annual reports for the programme manager and EU Delegation Albania
- Development of terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties (long-term and short-term experts) in carrying out project/programme's activities, including performance evaluation and impact monitoring
- Preparation and realisation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the programme's project's field of activities
- Organisation and facilitation of stakeholder meetings
- Support to the organisation and preparation of steering committee meetings
- Advises the AV on acquisition potential and modes for closer collaboration among development partners

Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts and dialogues with project partners, as well as with other projects in Albania in order to enhance and maintain good working relationships
- Communicates and channels local interests and exchanges ideas and information for the benefit of the programme
- Maintains repeated field visits to the project intervention area in accordance with the requirements of the project
- Implementation of the communication and visibility plan for EUSWAM

Knowledge management

- Participation in improving the programme's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Prepares reports and presentation materials
- Preparation of appropriate input to the various project/programme reports/publications including annual reports; contributes to other reports required by the Programme Manager, EU Delegation Albania and GIZ Headquarters.

Management and Coordination tasks

- Participation in the general project planning
- Coordination and prioritisation of relevant project activities in cooperation with the partners, and organisation and implementation of these activities
- Transparent documentation of the project progress for monitoring and evaluation

Required qualifications, competences and experience:

- Masters/PhD degree in civil engineering, business administration and/or national economy with experiences on the water sector
- Profound knowledge in institutional and organisational development of water sector organisations (Coaching, Facilitation, Change Management)
- At least 10 years of work experience in a relevant area
- Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
- Fluency in written and spoken English and Albanian, German language would be an asset
- Able to work in a team as well as independently
- Excellent analytical writing, social and communications skills

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period : 2 Years

Please forward your application until **21st of February 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Zv. ministrja e Arsimit: Si do të funksionojë projekti pilot, mësuesit e angazhuar

Besa Shahini: Rreth 70% e nxënësve pro nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë"

"Lehtësim i madh edhe për prindërit"

Projekti pilot "Bëjmë detyrat e shtëpisë" ka nisur të vihet në jetë në shkollat e Lezhës, si dhe në shkollën "Betim Muço" në Tiranë ditën e djeshme. Kjo nismë fillimisht do të zbatohet në 20 shkolla 9-vjeçare të pesë prej Drejtorive Arsimore Rajonale më të mëdha në vend ku përfshihet Tirana, Elbasani, Lezha, Korça dhe Fieri. Në një intervistë për News 24, zëvendës-ministrja e Arsimit Besa Shahini tregon se kjo nismë ka lindur si nevojë pasi jo të gjithë nxënësit i kanë kushtet dhe mundësitë për t'i bërë detyrat në shkollë. Më tej Shahini shpjegon nismën dhe shprehet se rreth 60-70% e nxënësve kanë rënë dakord për t'u bërë pjesë e projektit.

Në çfarë konsiston nisma "Të bëjmë bashkë detyrat e shtëpisë"?

Të bëjmë detyrat në shkollë është një projekt pilot ku ne e kemi zgjidhur ditën që fëmijët kalojnë në shkollë në mënyrë që t'i bëjnë detyrat e shtëpisë dhe mësimet për të nesërmen aty. Në këto 5 DAR-e kemi zgjedhur nga 4 shkolla, të cilat kanë kushte për të mbajtur ditën më gjatë, që punojnë vetëm me një turn si dhe që plotësojnë kushtet infrastrukturore të mundshme për ta aplikuar këtë projekt në mënyrë që nxënësit të rrinë pak më gjatë e të bëjnë detyrat aty.

Kjo nismë ka filluar të aplikohet fillimisht në Lezhë. Si shkoi ky projekt-pilot?

Lezha e ka filluar që tani, ndërsa në DAR-et e tjera do të fillojë zbatimi i pilot projektit gjatë kësaj jave e në fillim të javës tjetër. Në Lezhë deri më tani ka vijuar si duhet, pa probleme, ashtu si ne e kemi planifikuar dhe kanë sjellë ushqimet në shkollë. U nis nga muaji janar ku kemi bërë edhe trajnimet për mësuesit për t'i orientuar drejt asaj çka duhet të bëhet pasdite.

Cilat janë shkollat e kryeqytetit ku nxënësit do të bëjnë detyrat e shtëpisë në klasë?

Në Tiranë do të aplikohet në 4 shkolla: "Betim Muço", "Ardian Klosi",

"Hasan Tahsim" si dhe në shkollën "E Kuqe". Në shkollën "Betim Muço" projekti pilot do të nisë sot (dje), ndërsa në shkollat e tjera gjatë javës. Këto janë shkollat të reja që punojnë me një turn e i kanë të gjitha kushtet e përshtatshme për zbatimin e nismës.

Si do të jetë programimi i ditës tashmë për nxënësit që studiojnë në shkollat ku po zbatohet nisma?

Pasi përfundon mësimi i zakonshëm (për nxënësit e klasës 1-3 përfundon rreth orës 11.30 ndërsa për klasat më të larta rreth orës 13.15) bëhet një orë pushim dreke e cila në shkollat të ndryshme realizohet me kohëzgjatje të ndryshme që vari-



Zëvendësministrja e Arsimit, Besa Shahini, në intervistë për "News 24"

ojnë nga 40-60 minuta. Gjatë kësaj ore nxënësit hanë drekën, luajnë pak e fill pas kësaj ata kthehen në klasë për të bërë detyrat e shtëpisë. Pra, janë programuar dy orë për bërjen e detyrave dhe 1 orë tjetër shtesë për aktivitete që shkolla mund t'i organizojë me nxënësit.

Cili ka qenë reagimi i prindërve dhe a ka pasur ndonjë kërkesë nga ta?

Për prindërit që punojnë, projekti është një lehtësim shumë i madh pasi kur të kthehen në shtëpi, mund të kalojnë pak kohë me njërit-tjetrin, pa qenë e nevojshme të bëjnë detyrat. Ndërsa për prindërit që nuk e kanë ngritjen akademike për t'i ndihmuar fëmijët me detyrat, projekti është parë si një ndihmesë shumë e madhe pasi fëmijët e tyre kanë mundësi të jenë të suksesshëm. Për fëmijët e klasave nga e para në të tretën, prindërit kanë kërkuar që mos t'i mbajmë nxënësit shumë vonë në shkollë dhe të lirohen më herët që të mund të shkojnë në shtëpi rreth orës 14:00-14.30 dhe ndoshta orën e tretë të aktiviteteve nuk mund të qëndrojnë gjithmonë, por vetëm kanë drekën e bëjnë detyrat e shtëpisë.

Sa përqind e nxënësve kanë rënë dakord me nismën?

Prindërit në përgjithësi kanë rënë dakord, por ky deri më tani është një pilot projekt e iu kemi dhënë mundësinë që të shprehen



Foto ilustruese

"Aktualisht 60-70% e nxënësve që i kemi nëpër shkolla kanë qenë dakord për të marrë pjesë në programin e pasdites. Por nëse projekti shtrihet në të gjithë vendin, do të vihet në zbatim për të gjithë nxënësit, pra do të jetë i detyrueshëm", - u shpreh Shahini.

vullnetarisht ata që duan të marrin pjesë. Aktualisht 60-70% e nxënësve që i kemi nëpër shkolla kanë qenë dakord për të marrë pjesë në programin e pasdites. Por nëse projekti shtrihet në të

gjithë vendin, projekti do të vihet në zbatim për të gjithë nxënësit, pra do të jetë i detyrueshëm.

Cilët janë mësuesit që janë angazhuar për zbatimin e këtij projekti pilot?

Mësuesit që po merren me zbatimin e këtij projekti pilot janë grupe të ndryshme ku mund të përfshihen ata të paradites që nëse kanë orën e plotë mund të marrin deri në 6 orë shtesë e të

PROJEKTI PILOT

"Kjo nismë ishte e nevojshme pasi duhet të ketë barazi mes nxënësve, por meqenëse është një ngarkesë shumë e madhe për sistemin, menduam ta pilotonim në disa shkolla, për ta shtrirë më tej në gjithë Shqipërinë. Zbatimi i kësaj nisme koïncidon edhe me nismën tjetër "3 lëndë në 6 orë", - tha zv.ministrja e Arsimit.

paguhen sipas normave që ofrohen për punën shtesë. Në këtë projekt angazhohen edhe mësuesit praktikantë të cilët do të ndihmojnë me një pjesë të orëve si dhe ata mësues, që pas verifikimeve në sistem) nuk e kanë plotësuar normën në shkollën ku punojnë dhe janë në dispozicion për ta bërë këtë pjesë të punës pasdite. E rëndësishme është që mësuesi duhet të mbikëqyrë procesin e ai nuk ka nevojë që të angazhohet shumë në shpjegime, por thjesht të mbajë nën vëzhgim nxënësit teksa kryejnë detyrat e shtëpisë që të krijohet shprehja që fëmijët të mësohen me këtë mënyrë.

A u bë një trajnim për këta grupe mësuesish?

Ne kemi bërë takime të vazhdueshme me mësuesit ku u kemi shpjeguar nismën dhe ato çka presim nga ata pasdite. Për shkak se ky projekt nuk është zbatuar më parë në Shqipëri, e kemi parë të nevojshme që të realizojmë këto diskutime me mësuesit e kjo konsiston në bashkëbisedimet me ta në lidhje me çfarë do të thotë të bëhen detyrat e shtëpisë në klasë, mësimet për të nesërmen, çfarë lloj ndihme do i jepet nxënësit në rastet kur nxënësi ka nevojë për ndihmë në lëndë që mësuesi nuk i jep në shkollë.

Si lindi ideja e vënies në jetë të nismës "Të bëjmë detyrat e shtëpisë"?

Nga testet e ndryshme që kemi bërë nëpër shkolla dhe studimet në sistemin shkollos në Shqipëri e dimë që nxënësit të cilët kanë një gjendje sociale-ekonomike të mirë, nënat me arsim të lartë e që marrin ndihmë nga prindërit në detyrat e shtëpisë, dalin më mirë me rezultate. Kjo nismë ishte e nevojshme pasi duhet të ketë një barazi mes nxënësve, por meqenëse është një ngarkesë shumë e madhe për sistemin menduam ta pilotonim në disa shkolla, për ta shtrirë më tej në gjithë Shqipërinë. Zbatimi i kësaj nisme koïncidon edhe me nismën tjetër "3 lëndë në 6 orë".

Cili është mendimi juaj për nismën "3 lëndë në 6 orë"?

Me zbatimin e nismës "3 lëndë në 6 orë" është lehtësuar orari i nxënësve, të cilët kanë shumë më pak lëndë për të nesërmen e nxënësit me shumë lehtësi janë ulur për të bërë detyrat për të nesërmen.



Voltiza Duro

Sanca dëgjimore për implementimin e ligjit të arsimit të lartë u shoqërua me diskutime të shumta mes deputetëve të opozitës e zv. ministrit të arsimit të lartë, Ervin Demo. Edhe pse ka më shumë se dy vite që ka hyrë në fuqi, sipas opozitës, në ligjin e arsimit të lartë që po zbatohet nëpër universitete, mungojnë aktet nënligjore. Sipas tyre kjo situatë krijon probleme të shumta për sa i përket financimit, statusit të pedagogëve, titujve shkencorë e mbarëvajtjes së punës. Nisur nga këto shqetësime, deputetët e opozitës kanë ftuar në një seancë dëgjimore ministrin e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla për të diskutuar në lidhje me çështje. Por ministria nuk u paraqiti në mbledhje, pavarësisht konfirmimit të pjesëmarrjes, e kjo bëri që mbledhja të shtyhej. Sipas deputetës së PD-së, Albana Vokshi kushdo që shkel ligjin duhet të dalë para drejtësisë e më tej ka kërkuar përgjegjësit për çështjen. "Kush e mban përgjegjësinë për këtë? Kushdo që shkel ligjin duhet të shkojë përpara drejtësisë, hajde nxjerrim fajtorët këtu. Nuk mund të na çojë dikë tjetër këtu sepse i ka dalë përmbytja, të gjithë jemi dakord që duhet të shkojmë nëpër zona", u shpreh Vokshi

Shkak, mungesa e Nikollës. Rrokaj: Universiteti në kolaps. Demo: 80% e akteve ligjore, në fuqi

Opozita shtyn mbledhjen për ligjin e arsimit të lartë



Foto ilustruese

gjatë seancës dëgjimore. Ndërkaq, një tjetër deputet i Pd-së, Luciano Boçi theksoi se mungesa e ministres në mbledhje nuk është asgjë më shumë sesa dorëzim. "Për mua mosardhja e ministres është dorëzim, dorëheqje, sepse gjithçka që do zhvillohej në komisjon do tregojë qartë që kemi një ministri që nuk zba-

ton ligji që e ka hartuar vetë, që nuk miraton aktet nënligjore", tha Boçi. Kështu, mbledhja u shty deri në ditën kur Nikolla do të paraqitet, pasi sipas opozitës nuk mjafton prania e zv. ministrit të arsimit të lartë për zhvillimin e seancës. Edhe deputeti i LSI-së, Shezair Rrokaj theksoi se mungesa e akteve nënligjore për

implementimin e ligjit të arsimit të lartë i ka nxjerrë universitetet janë jashtë funksionit e në gjendje kolapsi. "Nuk është se ky ligj u vonua një javë, gati tre vjet po mbushen dhe universitetet janë në kolaps e nuk funksionojnë", tha Rrokaj në fjalën e tij. Ndërsa zv. ministri i arsimit të lartë, Ervin Demo sqaroi në një

prononcim për mediat se 80% e akteve nënligjore janë në fletoren zyrtare e kanë hyrë në fuqi. "Mbi 80% e akteve, mbi të gjitha aktet që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e sistemit, tashmë janë të gjitha në fuqi. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë që informacioni që del që ka kaos nëpër institucione, nuk besoj

se është e vërtetë. Aq më shumë bëhet fjalë për akte që i japin një lloj hapësire institucionit për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm që duhet të kenë. Këto bëhen edhe sa i përket hapjes së programeve të reja, doktoraturave, të gjitha akte që normalisht tashmë janë në fuqi", u shpreh Demo.

ALBANA VOKSHI



"Kush e mban përgjegjësinë për këtë? Kushdo që shkel ligjin duhet të shkojë përpara drejtësisë, hajde nxjerrim fajtorët këtu. Nuk mund të na çojë dikë tjetër këtu", - u shpreh Vokshi gjatë seancës dëgjimore.

SHEZAIR RROKAJ



Shezair Rrokaj theksoi se universitetet janë jashtë funksionit e në gjendje kolapsi. "Nuk është se ky ligj u vonua një javë, gati tre vjet po mbushen dhe universitetet janë në kolaps e nuk funksionojnë", - tha Rrokaj.

ERVIN DEMO



"Mbi 80% e akteve janë në fuqi. Është e rëndësishme të kuptojmë që informacioni i dalë se ka kaos në institucione, s'besoj se është i vërtetë. Aq më shumë bëhet fjalë për akte që i japin një lloj hapësire institucionit", - u shpreh Demo.



Implemented by **giz** German-Zusammenarbeit

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services and "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. The realisation of the EU action "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM) delegated to GIZ aims at implementing the second component of "IPA 2016 - Support to Water Management" sector programme, which seeks to enhance the implementation of the National Water Reform and the progress of Albania towards EU water legislation requirements. The specific objective of the EUSWAM Action is to reduce pollution in Adriatic coastal water via strengthened capacities and operation and maintenance of waste water infrastructure along the coast and in particular in selected municipalities that have benefited from EU support for the development of their waste water management infrastructure.

The EU financed project forms part of the CPWS and focuses on 4 components:

1. Improvement of the performance and performance reporting of selected waste water utilities along the coast of Albania
2. Strengthening of the capacity of the new National Agency for Water Supply and Waste Water (AKUK) with a particular focus on the waste water sub-sector in line with its recently approved enhanced mandate and policies
3. The improvement of the operation and maintenance of existing coastal waste water treatment plants (WWTP)
4. The build-up of the awareness and participation of the stakeholders of the waste water sector on the importance of (a) advancing the fulfilment of EU water regulatory requirement especially toward the Urban Waste water Treatment Directive (UWWTD) and (b) encouraging that water utilities delivering waste water related services (collection and treatment) are reasonably covering their costs to ensure sustainability of services in line with prevailing government policies in the sector

For the support of the GIZ programme team and for the improvement of the coastal WWTPs, covered by component 1, component 3 and partly component 4 (The build-up of the awareness and participation of the stakeholders of the waste water sector on the importance of ...encouraging that water utilities delivering waste water related services (collection and treatment) are reasonably covering their costs to ensure sustainability of services in line with prevailing government policies in the sector) GIZ Office Albania is looking for a

ADVISOR - WATER AND SANITATION

with special focus on sanitation (Sewage collection, waste water transport, waste water treatment, sampling, controlling effluents, operation and maintenance, Health and Safety Plans for staff, etc.).

A. Responsibilities

Enhancement of the GIZ programme team for the consultancy for municipalities and their water utilities to improve particularly the sanitation services. The advisory services for the coastal WWTPs shall be rendered on organisational, financial and particularly technical development and improvement, in a participatory manner with the staff and close cooperation with the programme team members. The senior expert will be responsible for the improvement of the management and the operation of the WWTPs.

B. Tasks

The Senior Expert WWTP performs the following tasks participatory with the partners:

For the WWTPs

- Development of Baseline studies
- Development of strategic business plans
- Development and implementation of operation and maintenance plans; monitoring of the
- Implementation of standard procedures
- Development of O&M monitoring system
- Development and implementation of health and safety plans
- Analysis of effluents
- Supervision and improvement of quality of effluents
- Orientation to operate the WWTP according to the EU Urban Waste Water Treatment Directive (UWWTD).

- Assistance in reporting of the performance (KPI based)
- Assistance in awareness raising campaigns of the WU/WWTP on EU waste water principles according to the communication and visibility plan for EUSWAM
- Cooperation with EU Information Centres

For the programme:

- Identification of needs for external support and advice for the WWTPs
- Follow-up of project progress and activities in close cooperation with the partners
- Contributing to and/or preparation of technical reports and to the annual reports for the programme manager and EU Delegation Albania
- Development of terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties (long-term and short-term experts) in carrying out project/programme's activities, including performance evaluation and impact monitoring
- Organisation and facilitation of stakeholder meetings
- Support to the organisation and preparation of steering committee meetings
- Preparation and realisation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the programme's/project's field of activities
- Advises the AV on acquisition potential and modes for closer collaboration among development partners

Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts and dialogues with project partners, as well as with other projects in Albania in order to enhance and maintain good working relationships
- Communicates and channels local interests and exchanges ideas and information for the benefit of the programme
- Maintains repeated field visits to the project intervention area in accordance with the requirements of the project

Knowledge management

- Participation in improving the programme's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Prepares reports and presentation materials
- Preparation of appropriate input to the various project/programme reports/publications including annual reports; contributes to other reports required by the Programme Manager, EU Delegation Albania and GIZ Headquarters.

Management and Coordination tasks

- Participation in the general project planning
- Coordination and prioritisation of relevant project activities in cooperation with the partners, and organisation and implementation of these activities
- Transparent documentation of the project progress for monitoring and evaluation

Required qualifications, competences and experience:

- Masters/PdD degree in civil engineering (Hydro technical engineering, Environmental engineering) or related fields or extended professional working experience
- Profound knowledge in WWTP O&M, management, financing
- At least 7 years of work experience in a relevant area
- Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
- Fluency in written and spoken English and Albanian; German language would be an asset
- Able to work in a team as well as independently
- Excellent social and communications skills

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana, regular missions to the coastal WWTPs/WUs and municipalities
- Assignment period: 2 years

Please forward your application until **21st of February 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Mungesa e konsensusit, Veseli: Është në interes të shtetësisë së vendit

Demarkacioni në Kosovë, Kuvendi shtyn ratifikimin

Kreu i LDK: S'vazhdohet kështu, duhet një qeveri e re

Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka shtyrë për një kohë të pacaktuar shqyrtimin dhe votimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit, ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Kryesia e ka marrë këtë vendim për shkak të mungesës së konsensusit politik. Demarkacioni është marrëveshje ndërkombëtare, andaj për ratifikim e saj nevojiten 80 vota, apo dy të tretat e votave të deputetëve. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli ka deklaruar se nuk do të lejohet që Kuvendi të jetë skenë teatrale ku persona të caktuar synojnë të sqarojnë inatet personale, të cilat do të reflektonin pastaj në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. "Asgjë nuk ka të jashtëzakonshme. Çështja e demarkacionit është interes i subjektivitetit ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës", - tha Veseli. Sipas tij, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është një mesazh i qartë se në çfarë drejtimi do të ecë Kosova. "Ka nevojë për një konsensus të gjerë nacional. Nuk është vetëm për liberalizimin e vizave, por edhe një drejtim pozitiv i partneritetit të vendeve të NATO-s", - theksoi Veseli. "Kërkova me mirëkuptim nga Kryesia që kjo pikë e rendit të ditës të jetë në një moment të caktuar kur do të ketë edhe një vendimarrje edhe më serioze. Kishte unanimitet, përveç LDK-së, e cila kërkoi që kjo çështje të jetë menjëherë në rend dite", - tha Veseli. Kurse, shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti tha se çështja e demarkacionit është shtyrë në një kohë të pacaktuar, edhe pse sipas tij, një vendim i tillë nuk është veprim i duhur. Ai theksoi se me vonesën e ratifikimit të demarkacionit, më së shumti po dëmtohen qytetarët. "Tri vjet po bëhen që kjo temë silllet poshtë e lartë, në pamundësi për t'u adresuar nga spektri politik. Ky koalicion është themeluar për të marrë këtë vendim, por edhe vendime të mëdha. Shihet qartë që këta janë të shpartalluar plotësisht në këto vendime. Unë besoj se kështu nuk mund të vazhdohet më. Vendi i duhet një qeveri e re që mund të adresojë nevojat e qytetarëve dhe vendimet që janë kapitale për të ardhmen e vendit", - tha Hoti. Analisti i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri tha për Radion Evropë e Lirë se vonesa e shqyrtimit apo edhe votimit



KADRI VESELI

"Asgjë nuk ka të jashtëzakonshme. Çështja e demarkacionit është interes i subjektivitetit ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës. Ka nevojë për një konsensus të gjerë nacional."



AVDULLAH HOTI

"Tri vjet po bëhen që kjo temë silllet poshtë e lartë, në pamundësi për t'u adresuar nga spektri politik. Ky koalicion është themeluar për të marrë këtë vendim, por edhe vendime të mëdha."

të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, po i izolon edhe më shumë qytetarët dhe vendin në përgjithësi. Ai thotë se drejtuesit e institucioneve të Kosovës ende nuk kanë ide të qartë për procedimin e

Demarkacionit. Ratifikimi i marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, tani për tani, praktikisht është i bllokuar në Kuvendin e Kosovës, për shkak të kundërshtimeve të një pjese të partive politike në push-

tet, por edhe një pjese të opozitës. Në këtë situatë, kërkohet një zgjidhje kreative, thonë zyrtarët të lartë të qeverisë së Kosovës, të cilët konfirmojnë se janë duke punuar për një zgjidhje të tillë. Ndërkohë që kryem-

inistri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, pritet që sot të vizitojë Kosovën me ftesë të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Kjo vizitë pritet të ndodhë në kohë kur Kuvendi i Kosovës pritet të deklarohet përfundimisht rreth Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, e cila është nënshkruar në vitin 2015. Këtë marrëveshje Kuvendi i Mali i Zi e ka ratifikuar, por jo edhe ai i Kosovës. Zyrtarët e institucioneve të Kosovës thanë të hënën se nga vizita e kryeministrit të Malit të Zi, Markoviq presin konfirmimin e vazhdimit të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore. Ata thanë po ashtu se çështja e Demarkacionit, nuk do t'i ndalë të dyja vendet drejt integritimeve euroatlantike.



"Gjaktarja e detit", SHBA-të prezantojnë luftanijen që shkatërroi nëndetëset armike

Marina amerikane ka nxjerrë për herë të parë luftanijen e fuqishme që mund të vëzhgojë e shkatërrojë të gjitha nëndetëset armike. E ashtuquajtura "Gjaktarja e detit", e gjatë 40 metra, kjo anije është programuar të udhëtojë me mijëra milje në det pa qenë nevoja të ketë asnjë anëtar ekuipazhi në bordin e saj. Ajo mund të lundrojë për muaj të tërë në det të hapur dhe të survejojë çfarë ndodh rreth e rrotull. Kjo anije përdor kamera dhe radarë për të gjurmuar pozicionin e anijeve të tjera. Anija anti-nëndetëse mund t'i bashkohet operimeve detare të SHBA-së këtë vit duke na futur në një epokë të re të luftanijeve.

Shqiptarët e burgosur në Britani, mediat: Duhet të ekstradoheshin para 5 vitesh, por...

Qindra të burgosur shqiptarë, të cilët ishin planifikuar për t'u ekstraduar nga burgjet e mbipopulluara të Britanisë në ato shqiptare, vazhdojnë të jenë ende në të njëjtin vend. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar në vitin 2013 dhe supozohej t'i shpëtonte taksapaguesve britanikë 25 milionë paund. Fillimisht do të ekstradoheshin vetëm 100 të burgosur shqiptarë, por e përditshmja britanike "The Sun" bën të ditur se vetëm 23 prej tyre janë ekstraduar. Shumë të burgosur e kanë kundërshtuar transferimin, duke iu referuar të drejtave të njeriut. Ata pretendojnë se duhet të qëndrojnë në Angli pavarësisht se kanë mashtuar në emër të azilit, duke u shtirur si refugjatë kosovarë. Shifrat e fundit tregojnë se janë 716 shqiptarë në burgjet britanike dhe pjesa më e madhe e tyre janë dënuar për vrasje, abuzime seksuale dhe për trafikim të lëndëve narkotike dhe kanë dënime afatgjata. Skema e vitit 2013 u mendua për shqiptarët e dënuar me katër vite ose më shumë. Madje shkruan "The Sun", kur u arrit marrëveshja, ministri britanik për burgjet Jeremy Wright

tha: "Më vjen mirë që nënshkruam një marrëveshje me palën shqiptare për transferimin e të burgosurve. Bashkëpunimi me autoritetet shqiptare ka qenë shumë i rëndësishëm për të siguruar këto negociata të cilat kanë qenë mjaft frytdhënëse. Qeveria britanike kërkoi që më shumë të burgosur të huaj të kryejnë dënimet e tyre në vendin e tyre. Do të vazhdojmë të punojmë me qeveritë e tjera për të ndarë praktikatat më të mira, për të përmirësuar standardet dhe për të shpëtuar paratë e taksapaguesve britanikë". Sipas "The Sun", javën e kaluar zyrtarët të ministritë britanike e zhvilluan bisedime me palën shqiptare për mënyrën sesi mund të përshejtohet procesi për të shpëtuar paratë e taksapaguesve. Ndërsa një postim në "Facebook" të ambasadës në Tiranë, që mban datën 30 janar 2018, thuhet se: "Gjykatësit, prokurorët dhe ekspertët britanikë dhe shqiptarë po kërkojnë mënyra të përmirësimit të marrëveshjes për transferimin e të burgosurve, mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë". Sakaq, theksohet se nga ana e zyrtarëve britanikë janë shqyrtuar 23 raste.



Kina denoncon strategjinë bërthamore të SHBA-ve: Reduktoni arsenalin

Kina kritikoi sot një raport të qeverisë amerikane që e përkufizon si një kundërshtar të mundshëm bërthamor, si dhe i bëri thirrje Uashingtonit të reduktojë arsenalin e tij bërthamor. Në një deklaratë zyrtare, zëdhënësi i Ministrisë së Mbrojtjes, Ren Guoqiang, thuhet se "Pala kineze shpreh kundërshtimin e saj të vendosur". "Shpeshohet se SHBA-ja do të braktisë mentalitetin e Luftës së Ftohtë dhe do të përmushë me sinqeritet përgjegjësitë e saj të veçanta për çarmatimin bërthamor", - vazhdon deklarata, ku premtohet, gjithashtu, se Kina nuk do të përdorë kurrë e para armët bërthamore "në asnjë rrethanë". Pentagoni botoi të premtën Pasqyrën e Gjendjes Bërthamore 2018, ku paraqiten planet e Shteteve të Bashkuara për të përditësuar arsenalin aktual, me qëllim parandalimin e sulmeve bërthamore. Dokumenti zërthen, gjithashtu, edhe një strategji të re për Kinën, me objektivin për "të parandaluar mundësinë që Pekini të arrijë në konkluzionin e gabuar se do të ishte e pranueshme të arrinte avantazh nëpërmjet përdorimit të kufizuar të aftësive bërthamore, apo të të gjitha llojeve të armëve bërthamore", shkruan "Rel". Kina ka arsenalin e pestë më të madh bërthamor në botë, me 270 mbushje raketash bërthamore, sipas të dhënave të raportit të botuar në muajin qershor nga Instituti Kërkimor për Paqen Botërore në Stockholm. Sipas të njëjtit raport, Shtetet e Bashkuara radhitën menjëherë pas Rusisë, me 6800 mbushje bërthamore.

Ahmeti "fshin" historinë me Kurtin, heq të gjitha fotot me të

Të dorëhequrit e VV-së me parti të re, pritet t'iu bashkohet edhe një emër i njohur

Vetëvendosja në zgjedhjet e këtij viti krenohet me rezultatin që u sollë grupin më të madh parlamentar me dy komuna të reja të fituara, duke mbajtur ndërkohë edhe për një mandat kryeqytetin. Por ky triumf u thye, pas akuzave e fyerjeve që bënë që VV-ja të humbë edhe këta dy kryetarë, 10 deputetë, ndër ta edhe themelues, ish-kryetarë e figura që morën mijëra vota në zgjedhje. Nga fillimi i dhjetorit kur edhe u bë publik mesazhi ofendues që deputetja Aida Dërduti ia dedikonte Albin Kurtit, në kohën kur ai po arrestohej nga policia, kanë plasur tensione brenda partisë, që kanë rezultuar me

OPINIONISTI
"Në opinionin publik është krijuar përshtypja që Ahmeti i përket këtij grupi dhe do të largohet për t'iu bashkuar atij. Edhe VV-ja tashmë e di që ai do të largohet. Subjekti i ri nuk do ta ketë rëndësinë e njëjtë, nëse Ahmeti nuk del aty, ai do të mund ta kompletonte dhe do t'i jepte fuqi kësaj partie.

dorëheqje e fyerje të shumta. Por, i pari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ishte ai që qëndronte i papërcaktuar në këtë situatë, duke mos bërë publik qëndrimin e tij. Si duket, mospërcaktimi i

Ahmetit është edhe arsyeja pse partia e përfolur nga Dardan Molliqaj e Visar Ymeri ka vonuar. Gazeta Express mëson nga burimet se tashmë të gjithë anëtarët dhe ish-anëtarët e partisë janë të in-

formuar se nga VV-ja do të krijohet një parti e re dhe do të ndahet grupi parlamentar. Mirëpo, në Kuvendin e Kosovës është deklaruar se një kërkesë të tillë ende nuk e kanë marrë. Por, mesazhi që ka dërguar kryetari i kryeqytetit me fshirjen e të gjitha fotove nga rrjetet sociale që kishte me 'babën' e partisë, tregon që ai veç se është rreshtuar së bashku me Molliqaj e Ymerin. Njësoj si ai, edhe kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrioti, radhitet në anën e të



dorëhequrve. Me këtë Vetëvendosja humb dy komuna, pa përmendur Prizrenin, kryetari i të cilës Mytaher Haskuka radhitet në anën e Kurtit. Express kishte raportuar se arsyeja pse Ahmeti kishte marrë qëndrim neutral ishte për të mbajtur një balancë brenda Asamblesë Komunalet, edhe pse kishte numër më të madh të përkrahësve sesa i pari i partisë. Analisti

politik, Imer Mushkolaj, tha se në Vetëvendosje tani e dinë që Ahmeti do të largohet. "Në opinionin publik është krijuar përshtypja që Ahmeti i përket këtij grupi dhe do të largohet për t'iu bashkuar këtij grupi, edhe VV-ja tashmë e di që ai do të largohet nga ky grup. Subjekti i ri nuk do ta ketë rëndësinë e njëjtë, nëse Ahmeti nuk del aty, ai do të mund ta kompletonte dhe do t'i jepte fuqi kësaj partie. Në anën tjetër, ajo dëmon Vetëvendosjen", deklaroi ai. Sipas Mushkolajt nëse tashmë Ahmeti del nga VV-ja, kjo nuk do ta dëmtojë atë brenda komunës, sepse, tanimë ai ka koalicion me disa parti, duke përfshirë edhe parti të vogla dhe gëzon numër më të madh të asamblistëve se krahu i Kurtit.

Vizita në Romë e kreut të Turqisë, kurdët e presin me protesta

Erdogan takon Papën, vizita e parë pas 59 vitesh

Presidenti turk për "La Stampa": BE të mbajë premtimin

Ditën e djeshme, në Vatikan nisi takimi kokë më kokë mes presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe liderit shpirtëror të katolikëve, Papa Françesku, raporton Anadolu Agency (AA). Papa priti presidentin Erdogan në hyrjen e Sallës së Bibliotekës në Pallatin Apostolik, ku lideri i botës katolike pret mysafirët. "Ju faleminderit për kujdesin", është shprehur presidenti Erdogan, ndërkohë që edhe Papa ka falënderuar presidentin turk për vizitën. Erdogan dhe Papa Françesku shtrënguan duart para përfaqësuesve të medimeve, ndërsa më pas kaluan në Sallën e Bibliotekës, ku mbajtën takimin kokë më kokë, i cili u zhvillua në detyrë të mbyllura për medimet. Kjo është vizita e parë e një presidenti turk pas 59 vitesh që viziton Vatikanin. Mësohet se temë kryesore mes presidentit turk dhe Papës është terrorizmi dhe vendimi për Jerusalemin. Vizita e Erdogani në Vatikan është shoqëruar me masa të forta sigurie. Në Romë duke nisur nga dita e djeshme e deri në largimin e Presidentit Erdoğan në qytet ishin në detyrë 3.500 forca të sigurisë. Siguri e lartë sikurse për Trumpin apo Putinin. Të njëjtat masa edhe për presidentin turk Rexhep Taip Erdogan në Romë. Vizitën zyrtare në Itali e nisi në Vatikanin që nuk vizitohet nga presidentët e Turqisë prej 6 dekadash. Takimi me Papa Françeskun zgjati për 50 minuta, ku tema kryesore të diskutimit ishin Jerusalemi, që administrata Trump e njohu



Erdogan i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe lideri shpirtëror i katolikëve, Papa Françesku

si kryeqytet të Izraelit, por edhe çështjet e të drejtave të njeriut. Shkëmbjen së bashku edhe dhurata. Përoramës së Stambollit në qeramikë që i dhuroi Erdoğan, Papa Françesku ia ktheu me një medalion të Engjëllit të Paqes, që largon djajtë e luftës. Një dhuratë domethënëse, tekta Turqia po kryen në sulm ushtarak në Siri kundër militantëve kurdë. Edhe në Romë, Erdogani e ndoqën protestat e kurdeve, ku në përleshjet me policinë italiane pati edhe të plagosur. Në një intervistë për mediat italiane Erdoğan kërkoi

nga Bashkimi Europian t'i mbajnë dyert e hapura për Turqinë. Por në përgjigjen nga Brukseli thuhet se kjo është ende larg, pasi nuk është konstatuar asnjë përmirësim me të drejtat e njeriut çka do të pasqyrohet në raportin e prillit. Ndonëse policia italiane kishte marrë një sërë masash për vizitën e presidentit turk në Romë, dhe ishin ndaluar protestat, një gjë e tillë ka ndodhur. Komuniteti kurd ka manifestuar sot në Romë kundër vizitës zyrtare të Presidentit turk Rexhep Taip Erdogan në Itali. Protesta e

tyre është zhvilluar në kështjellën "Sant'Angelo" jashtë zonës së blinduar nën masa mjaft të larta nën kontrollin e policisë italiane, për të garantuar sigurinë e vizitës së presidentit turk. Nën thirrjet e parullat "Erdogan vrasës", "Larg duart nga Kurdisjtani", i janë bashkuar kësaj proteste mjaft aktivistë të organizatave joqeveritare italiane në mbrojtje të lirisë e të drejtave njerëzore. Një prej manifestuesve ka propozuar, duke marrë me vete turmen, për të vazhduar protestën në Vatikan ku po zhvillohej dhe vizita.

Ndërkohë që, nga ana tjetër, Presidenti Rexhep Taip Erdogan i kërkoi BE-së që të mbajë premtimin lidhur me aderimin e Turqisë. Në një intervistë për të përditshmen italiane "La Stampa", gjatë një vizite zyrtare që po zhvillon në Romë, ai, gjithashtu, tha se duhet të ruhet statusi i qytetit të Jerusalemit. "Pranimi i Turqisë në BE nuk mund të flijohet në llogaritjet e politikës së brendshme - tha ai - dhe Jerusalemi nuk është thjesht një çështje e myslimanëve". Sipas presidentit turk, statusi i këtij qyteti "duhet të ruhet bazuar në rezolutat e OKB-së, duke siguruar që myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë të jetojnë në paqe krah për krah". Kreu i shtetit turk flet edhe për ndërhyrjen turke në provincën siriane Afrin: "Luftojmë vetëm terroristët dhe kemi të drejtë ta bëjmë këtë". Ai siguron që Ankara do të kontribuojë në integritetin territorial të Sirisë. Gjithashtu, përsërit se nuk është pushues. Sa i përket Libisë, Erdogan thotë se "Turqia mbështet integritetin territorial libik dhe unionin e saj politik". Presidenti turk rikujton që Roma dhe Ankara kanë rinisur aktivitetet në ambasadat e tyre në Tripoli dhe premtoi se shumë shpejt do të jetë operativ një grup pune i përbashkët për të zgjidhur krizën e brendshme.

RECEP TAYYIP ERDOGAN

Pranimi i Turqisë në BE nuk mund të flijohet në llogaritjet e politikës së brendshme dhe Jerusalemi s'është thjesht një çështje e myslimanëve. Statusi i këtij qyteti duhet të ruhet bazuar në rezolutat e OKB-së, duke siguruar që myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë të jetojnë në paqe krah për krah.

Cipras: Do të bëj më të mirën për zgjidhjen e çështjes së emrit me Shkupin

Kam përgjegjësi për para vendit tim, deklaroi kryeministri grek, Aleksis Cipras gjatë një takimi me liderin e opozitës "Demokracia e re" (ND), Qiriakos Micotaqis, njoftuan burime qeveritare. "Micotaqis e akuzon shefin e qeverisë greke se ka ngritur çështjen e emrit të Maqedonisë për shkaqe politike, saktësisht për të përçarë partinë e djathtë opozitare ND", shtuan ato. "Ndërkohë, Cipras siguroi liderin e opozitës se nuk e kish të ndërmarrë këtë veprim as për të përçarë opozitën dhe as për ta bashkuar atë", thanë burimet. "Për sa kohë do të jem kryeministri i vendit, unë do të kem përgjegjësi përballë tij dhe historisë", - theksoi Cipras. "Unë do të bëj më të mirën time për zgjidhjen e kësaj çështje", - përfundoi ai.

ESE

Nga Piro Loli

Kënga e Solomonit është këngë biblike. Është Kënga e këngëve, ose kënga e dashurisë. Ka mijëra vjet që ecën drejt nesh, drejt çdo çfiti të dashuruar. Dy trupa mish e shpirt, dy buzë të kuqa që puthen, e brishtë me aromë e verëkuqe, romantike e qiellore, por dhe tokësore me luftën për të jetuar e me dramën zakonshme të njeriut. Mirë se vjen Sulamith! Me këto këngë në buzë erdhi dhe Sadik Bejko te vëllimi i fundit, më kulmori i vlerave të poezisë së tij. Mirë se vjen poet!

Dashurinë dhe femrën Bejko e krahason me forcën e gravitetit. "Ty, e dashur, doja të ta dhuroja sot/sy për sy gjallë e të prekëshme/Këtë Shqipëri të gurit dhe të karafilave. Por te "Shqipëria e karafilave" simboli i karafilit, i bukurisë e begatisë në vendin tonë i mbetet vetëm dëshirë e paralelizuar. Amaneti qenka i rëndë. I zi. Mbushur me mort. Brenga dhe poeti mbajnë njëri tjetrin mbi shpinë. Karafilat kthehen në krizantema që "vetum vorreve lulzonte"(Mjeda) e: "kjo rrëngëthje erë varri /si ledhatim i ri më ngjet"(Esenini) E Motra e poetit, ajo e mira, fisnikja, e brishta si shpirti qan: "vdekje të zeza burrash, në temtha kyçur/ me tym baroti të nxehtë/ shkrehur nga gëzhoja të nxira". Me një krah karafilash mbi varre - ato, ato, - motrat e gratë, nënat e të dashurat tona, rënor në gjunjë mbi baltën e varrit u dridhet tufa e karafilave në duar e bëhen të zinj, të zinj - si nata krizantema mbi varrepor, për poetin, "Brenga mund të pastrojë ajrin e planetit gjer te zemra". "Këngë të Solomonit" është plot e përplot me këngë të trishtuara Sadiku ka një përvojë të pasur jetësore dhe artistike. Jeta e tij plot zigzake nga mësuës në një fshat të humbur tek profesor universiteti te doktor i shkencave filologjike; nga punëtori i minierës deri te deputeti. Ai, mbi të gjitha është poet, e pastaj pedagog e orator i talentuar më zë basi, shkrimtar, studiues, eseist, e së fundi sekretar i përgjithshëm i PEN-it shqiptar. Është poeti që e shtrijdh botën "që krijon" vetë, e banon intensivisht me tërë forcën e ndjenjave përmes një ankthi gjetjesh të papritura plot emocione e mendime origjinale. Është këndi i pjerrët e ekzistencës së një poeti që e di peshën e figurës artistike, asaj përtej përvojës, metaforës që merr trajtën e një genie unike në thellbin e vet, sa intim, aq prani tjetër për tjetrin. Ky poet është i zymtë, i thellë, i menduar. Një kampion që kumbon në heshtje e ndonjëherë duket se i njeh të gjithë rrathtë e ferrit. Sadiku ka qenë ca vjet nëntokë, (dënuar nga 1973-1) dhe e di mirë baltën dhe terrin e zi të minierës). E njoh hap pas hapi jetën e tij dhe kudo e kurdoherë ka pasur një dritë të brendshme në shpirt. Është poezia shpirti i tij.

BOTA MË PËRTEJ

Së pari Sadik Bejko është mjeshër i portretizimit. Ai ka syrin e piktorit që zgjedh kë të pikturojë. Ato që nuk i sheh dot ngjyra i shpreh fjala. Dhe ka intuitën të gjeje çka guri në zemër, çka mali e krokodili, e gruaja që dashuron, motra dhe stërgjyshi harruar. Portretet poetik të tij, jo vetëm te ky vëllim, e

Sadik Bejko

Një kampion që kumbon në heshtje, poeti i dënuar që punoi në minierë



Në foto: Kopertina e librit

zgjerojnë botën. Kur lexon diçka nga dimri ke lexuar borën në gjakun e plakat. Dhe fjala e tij i ka të gjitha ngjyrat dhe nuancat (në penel) deri te kapllarët e padukshëm mbi gjethe. Pikturon të bardhën duke shkallëzuar mbi të bardhën, të zezën me më të zezën dhe, krejt asosacionet e fituara me këtë sintaksë të re poetike, e shtynë njohjen më tej. Kështu portreti poetik i botës shkallë-shkallë a shtresë-shtresë si te pikturat e Rembrandt në relie, duket si i gjallë. E objekti ka marrë emër tjetër. Poeti është buti i tharë i verës, gropa me sytë plot ujë me akull anash, vresht Ai hap gropa. Mbjell ullin për vaj rrush për verë. Vresht i vjetër fidanë të rinj. Shihen si fshin vesën e ngrohtë syve. Dhe ëndërron. Mendon. Dyshon. E përsëri ëndërron. Ndoshta sheh mesnatave që vinë e "rrëmbushet me vje". Por është dhe njeriu, krejt i përkohshmi. Dhe bëhet prej drite edhe për një gjest njerëzor, atje ku e priste krahëhapur gruaja, tryeza, shtrati. Një gjest, vetëm një. Sa pak, sa pak

Mbi "Këngë të Solomonit", doktori i shkencave filologjike që u bë deputet

duan poetit! E dritëzohet i tëri. Si luleferra, lulebajama. Një gjest njerëzor. Një. Dhe: Të lindin cunat të përcillen me lule pleqtë Te poezia tjetër "Ikja e bukur", plaku pas lëngatash, i bukur ngjan tash në vdekje "Me pamje dhëndërrit e djali, anipse "Shtatë grykë të njoma bijash në kor e qanin" e "mbi varr një gështenjë, roje e fortë si gruaja çdo ditë e natë plakat do t'ia lëmojë shtatin e, vazhdimësia e brezi i ngjall të blertat

mbi pemë Janë të bukur pleqtë e Sadikut. Ai kërkon mëshirë për dimrin. Është shenjtëria e gjyshtë që po ikën. . Me sytë borë e akull. Mëshirë për këta lot. Mes ngrica vdesin Toka këta i pranon me burjari. E rrënjat mbetet rrënjë. E bari mungulloi si pushi mbi faqen e çunave. Te "Lamtumirat"-Një tjetër portret madhështor. Një gjetje mbresëlënëse. Rrapi, ashtu i rreptë, një rrap që flet. Me një brengë të madhe në çdo kërcell. Dhimbje burri, e brendshme nëpër damarë, e patreguar. Durimmadh ky burrë, si rrapi. Ikni të gjithë prej meje, thotë. Unë jam rrapi i vjetër që mbetet me sy nën lëkurë nën degë/ të shoh kush po ikën tash e parë". E rrapi zemër madh: Të lumtur për ç'qemë tok në çastin a orën e bardhë". Prej tij ikin të gjithë. Gjethe, zogi, degë të thara, bryma, bora, shiu- në prill e në maj. Mua këtu më keni. Prerë rrënjësh, në gur e në baltë. Le të vijë uragani, të më shkullë nga rrënjët. Tu lë tumirë furtuna të dashura. tumirë gjejt e mi, ajri im, dielli im. Dhe natë. Ama, natë e bardhë. Për burrin e rrapit

Poezia "Një vjollcë, ka vetëm

pesë vargje. Është fjala që dredhon për atë që do të thotë. Thelbi që nuk duket ndrit si lulevjlollcë. Dhe më poshtë nxin si rubin i zi. "Një vjollcë i ka mbirë te shtati e lulezon gjer në fytirë". Vitraina u tha, u pa. Por autori humbtka nëpër renë e saj dhe çudia nuk vazhdon gjatë. Filon të zbardhet, "në blunë e saj je shaluar". E pastaj: Shkelmimet, gjënimet, e humbjes/ nëpër gjejt / kumbojnë". Jo pra, jo. Vjollca s'është e tillë. Rendi, po. Pushteti po. Partitë, po. Dhe demokracia në blu shaluar. Dhe ajo i zhgënjën disa. Të parët militanët. Se ky djallo shteti ynë e këto parti të shtrokan edhe për në "Festa" mjalitë të dhukur "Burrnësja" krejt origjinale pena e portit dhe krejt e përveçme drama e saj. Fytyra e saj, tashmë mbuluar me rrudha "rrufitur; rrudhosur; balli, mollëzat gjer në vesh". Gjarpri e ka shkelur dhe merimanga. Po "syri i kthjellët e shpuës, far në hon ferrri, yll në hartë humnerë" me një monolog tronditës ajo bën dy goditje. Një, ndaj vetes ("barbare, primitive", "ke helm të helmsh, ke zjarr të vësh flakën, ke dinamit sa hedh në erë galeritë e ferrit"). Dy: ndaj atyre që i thonë, prano që je e tillë; ajo pranon "meqë e thënkji ju". Cilët janë ata që e akuzojnë, e di lexuesi. Para nesh ngrihet portreti i saj. Vini re shkallëzimin mjeshhtëror të fjalës së poetit "gozhdë e zezë në fytirën e kohës", pus dritehënor, thëngjill i zi. Dhe më tej: jam burrnesha, shkrepëtimë e shuar, gjejt i rënë mali, e zeza e grykës së pusit, akull, thëngjill në hi seksi shuar. Fajtoje apo viktimë? Fat apo fataliteti i imponuar? Lexuesi mund të ofrojë disa lexime.

PESHA E FJALËS

Poezia e Sadik Bejkos te libri i fundit "Këngë të Solomonit" është kuota më e lartë e vlerave të këtij autori. Kjo poezi është guximi i të



pathënë. Lartësimi i fjalës shqipe. Përbrenda saj është aftësia dhe prirja për të heshtur, për të heshtur për gjërat që dihen, për ato që nuk thonë asgjë. Ky poet e percepton poezinë si lirë shprehjeje, jo vetëm si harmoni formale, por dhe si një gjetje, si një zbulim në marrëdhënie të tjera. Fjala e tij e zgjedhur triumfon në zgrip të vetvetes. Ajo kumbon dhe e merr dimensionin e saj tej vetvetes, në mosduke. E fjala artistike, ngjyra, tingulli veç sekreteve brenda gjinisë, karakterizohen nga ajo mjeshteri artistike dhe ka dy sekrete të mëdha: e para, ta zbulojë sendin që do eksplorojë, e dyta, ta fshëjë (Oaze). Poezia e Bejkos duket sikur është krejt një monolog. I ndërgjegjshëm. Ai ëndërron. Ai di. - Të dish, d.m.th., të dyshosh. Kjo është prirje erudicioni në kërkim të vetvetes. Jo vetëm për njeriun gjenetik, jo, por për genien Poet. Ai e di se duhet ndryshuar statusi i sendeve, dhe brenda përvojës së tij, me guxim merr përsipër riemërimin e gjerave. Nuk është poeti që pozon për t'i pëlqyer dikujt. E veçanërisht masës, ai është një dorë e zgjatur tek tjetri; ai ecën duke kërkuar një copë tokë, një hëhë tjetër, një rreze dielli. Fjala e tij shkon atje ku diçka mungon. Ai e di se çelësi i jetëgjatësisë së poezisë është forma dhe më i drejti kriter e moral i vlerave, është njohja e së keqes. Koha tek ky poet →



Në foto:
Sadik Bejko

← nuk ka kahje. "Koha shndrrit në ëndërr e kjo do të thotë të dish" (Valery). Gjithmonë dicka i ndodh kohës. Dicka si frakturat. E përgjigjen e saktë e jep vetëm fjala poetike. Kjo poezi e njëhastin historik. Dhe formën e ka në sallonin e modës. S. Bejko, është nga të rrallët poetë shqiptarë që i ka qëndruar fjalës poetike (vetvetes) pa lëkundje, pa spërdredhje rrethana. Ai e ka ditur fort mirë se antenat e vlerave poetike drejtohen nga figuracioni i ngjeshur. Mbi bazën e krahasimit Bejko gjen metaforën dhe simbolin më të çuditshëm, të papriturën. Atë që mungon. Gjetja e formës kërkon dhe thellësinë e mendimit, trajtimin enigmatik përmes një sintakse poetike të zhërvjellët. Pikërisht këto cilësi të lakmueshme nga poezia moderne, kalojnë në heshtje e shpërfillje nga syri dhe vëmendja e opinionëve masiviste, reklamave, popullaritetit fals e festave amator-ëske. Poeti i vërtetë nuk bie në kurthet e bashkohësive e mediokritetit festiv; nuk noton në ujërave të cekëta, lehtësisht të ndjeshme e të turbullueshme, që nuk mund të bëjnë dot as valëza, pa le dallgë. Fjala te poezia e Sadikut është zgjedhura e "ustait". E limuar e kalitur në duar të sigurta. Drejt një sigurie gjithnjë në rritje. Ajo arrin deri te vetvetja e mund të flasë edhe nga guaska në fund të detit, edhe nga zemra e gurit a nga venat e gjethes. Fjala e tij

plot larmi, një prurje e heshtur në letërsinë shqipe, drejt thelbeve të pashprehura, ashtu drejt bregëve e dallgëve të shpirtit, ashtu e befte për të krijuar lidhje e semantika të pabesueshme, thërret, ulërin, qesh e qan, ironizon çjerr maska, shënon në lule të ballit të keqen te individit e shoqëria, te vendlindja e atdheu. Kjo është poezi me pak natë. Ajo qëllon edhe të zotit, edhe të dashurën. E vërteta e tij qëndron te detaji. Ai nuk flet me askënd. Ndoshta një trëndafil që u zgjatet të gjithëve. Në heshtje. Fjala e Sadikut, është zonja e rëndë që sfiqon të zakonshmen dhe e gjen vendin atje ku metafora shkon drejt absurdit. Është kjo fjala e zgjedhur poetike, që të merr prej dore e të tregon parajsën, rrugëve plot aroma e sende të arta, por dyqanet e gjen të mbyllur; më e sigurt drejt ferrit, tek e errta mbi të errtën, te zbritja a te rënia e njeriut. Gjithsesi fjala poetike nuk kërkon stacion, as adresë, jo, ajo veç ndërton shkallët e nevojshme për ngjitje a zbritje, ajo shtron udhët për të tjetri, e lumi flet, kërkthiza lidhet me degën e rrufesë, bryma shpon me gjilpëra, "mosi" te ballkanasi, bëhet "mosi i mosit të mosit" e ulërima shket rrafsh pyllit me brymë; fjala e tij të qep mbyllur në gjethë dhe bota me një figuracion të tillë, zgjerohet dhe merr emër tjetër. Poezia e Bejkos është solide. Nuk është fjala vetëm për rritimin, rimën, ko-

mpozicionin, simetrinë a asimetrinë, figuracionin në tërësi, por, për të gjithë elementet e ndjeshmërisë, që i rezistojnë harrësës, pra, krejt unitetin e brendshëm të poezisë. Në penën e poetit shqipja jonë lartësohet e pasurohet duke dëshmuar mundësi të larmishme shprehjeje, sintaksë të pasur poetike; atje te fjala e rrallë, te lidhja e re me fjalën tjetër; te kompleksit semantik, te ngjitja e simbolit në absurd, deri te neologjizma si pasuri leksimore, si: përhimje, tumirë, curgoj, rrëmbush, terrim, udhëshetur, gavrur, krisë, sosurë, zgabërojtagh e parë, etj. Është pikërisht kompleksit poetik që poeti rritet brenda tjetrit për të parë e zbuluar gjërat që duam. Poezia e tij është për ata që dinë të lexojnë.


AJO, FORCA E GRAVITETIT

Është dashuria, është gruaja. Ajo, nëna, motra, femra - ajo dashuria - tematika më e gjerë e të gjithë poetëve në botë. "E gjithë bota vjen nga sytë e tu të pastër / dhe gjaku im rrjedh në ato shikime" (Pesoa) Emri i saj është puthje në sy. Te "Këngë të Solomonit", që në faqen e parë, Bejko e krahason me forcën e gravitetit. Ajo rrotullon planetët e pastaj zbrer nga lartësitë e kozmosit në: "zgjuar vështrimi im rreh të cekë sytë e tu". Për të gruaja (dashuria) asgjë nuk e ndalon, as pritja, as nata, as akulli në Arktik. Dhe vetë Zotin po ta kesh, "pa ty dashuri nuk je asgjë" Femrën e do si arusha e uritur hoinj me mjalte. Për Zotin, nuk di pse Zoti e quaji si mëkat veprën e tij më të bukur. (!), (13:13) e përpiloi kodin penal për njerëzimin. Vetë Zoti është dashuri, ndoshta vetë jeta, e Bibla si kryeliber; është "Kënga e këngëve". Ose metaforë. Poeti këmbëngul përtej Evës mëkatë "Qiri kolonë flake, ndezur në diell. Dy trupa harkuar një mbi një jam asgjë pa ty dashuri

"Kleopatra ime" dhe Kënga e Solomonit janë dy poema të vogla por madhështore në formë e mesazh - e pa ndrojtë - them se, mund të kenë një vend nderi në ballorin e poezisë shqipe. E para: Fjala që ngre monumentin me emrin "dashuri". Ajo, gruaja, mund të jetë Kleopatra historike e Cezarit a Mark Antonit, por dhe kleopatrat tona, pse jo. Është e kundondodhura, në çdo qelizë të jetës - gruaja - në pushtet e padukura, oaz në shkretëtirë, - ajo mbretëresha, mjalte dhe kobra "fshehur nën dy thimtha gjarpri a nën dy gjethë fiku". "Dhe qëmshëti thellë të shëgët e cicave nën dy sumbulla gjiri". Pastaj befasisht: Kobra më je ti, zemra ime - e vezullim të bie ora, bie ora. Ikim. Vdesim. Medet. Nuk do jesh më bijë Mesdheu syftohtë. Pak verë, pak ajër; pak gjuhë gjarpri, pak qiell helmi, në kokërr fiku ëmbël kyçur". Po po e tëra, plotësuar helmi dhe mjalte, engjëlli dhe kobra. E ja këshuta, na thotë poeti ajo mund të jetë busull për Cezar e Mark Anon, por dhe imja a jotja, gruaja, zemra ime që shpall mëngezet e argjendta e rrotullon planetët.

LIBRI

"Kënga e Solomonit" që mban dhe titullin e librit tingëllon akoma më kozmike dhe, sa të ketë jetë njeriu do jetë gjithnjë aktuale. Po vjen ajo, Sulamitit. E dashura. Ka 3000 vjetë që udhëton e tani po e pret poeti me krahë hapur. Dhe unë, dhe ti. Ajo është dashuria vetë, kryevepra e "Kënga e Këngëve", zbritur nga Bibla, (supozohet e shkruar nga Solomoni). Mirë se erdhe Sulamitit! Gjithnjë e freskët, e ringjallur: Ajo,



e brishta si aromë, e tmerrshma si ushtri. Vini re absurdin hiperbolik: "Si një ujkonjë që meshkujt i gëlltit / i bën mollë për gjirin / i bën argjend për shkëmbin". "Mirë se erdhe maleve dhe valtheve, ujrave dhe zalleve / Trëndafilë e brishtë erdhe sot me emër tjetër, erdhe te zemra e zemrave me emrin dashuri; trëndafilë e qiri që digjet në krahët e mi, trëndafilë e dritës Sulamit. Tani që nata ra më verbohën sytë, më lbyren llërët, supet, këmbët e tua më ngulen në sy / Tërësi, ngrohtësi, avull e fildishe të dy, në lumin lëkurëhollë të kësaj nate lëvrinë, lëbyren, zhyten / Oh, oh! Sonte e dua terrin të ndezur me shpatat e diellit në mish. Është ajo, burim jete e njeriu me zemër në dorë (poeti) thërret: Dil, shfaqu ngjyrave, pa rënë në natë; lermë të të shoh siç je, sa pavdekur sytë. Si një sandalle shqyer nga rëra Por poeti vigjëlon dhe në dashuri. Bejko këtu shfaqet më purist se puristët. Seç ka një bregë e pa na i thënë ne, ia thotë asaj. "Mos më tako për ditë, as nesër, e pasnesër, as pas një viti e një shekulli. (!) - "takomë kur të jesh vetvetja. Vetëm e për veten tënde pa kohë pa hapësirë, pa asnjë prani tjetër mes nesh, qoftë dhe sa një qime floku / Është drama e jetës kjo. Bregat janë subjektive. Dashuria e sinqertë kërkonka vetëdije absolute. Ka dhe asoka. Dhe hipokrizi. Pavarësia absolute është e pamundur. Tapitë maskullore kanë ardhur duke u zhvleftësuar. Të paluajtshme në banalitetet e tregut (si sot) Puristi solomoni i përmbahet perceptimit hyjnor të dashurisë. Plot hire. Dhe poeti. E mesazhi ikën nga poeti, nga unë e nga ti e bëhet kozmik, i përjetshëm pa pikëpyetje; ajo, ashtu e bukur përmbi dallgë, përmbi re, përndritëse përmbi vij sikundur na thërret që nga kopshti i Edenit Eva e parë që guxoi jetën e zbriti në tokë si mollë e ndalueme. Pa mëkat. E cili individ nuk do të donte ta kish të tillën? E ajo vazhdimisht në çdo kohë ka vetëm një këngë në gojë: E shihni? Më shihni? Bukur. E bukur jam. Lumtur, e lumtur jam. Vetëm në dashuri jam. E atje bëhem më e bukur.

BRENGA

Është tipar dallues i këtij poeti. Krejt gjoksi i tij është imbushur me poezinë e dhimbjes. Është gurëzuar si gungë, i mblihdet në fyt dhe e djeg. Qenka e domosdoshme "si bleta hap dhomëza të holla sa hojet, vë dritë, zemrën e mbetur të orëve nga e para e kurdis" Këtë gungë në gjoks të poetit e shoh jo vetëm te poezia "Brennga", por tej e përtej krijimtarisë së tij shumë të pasur [Vetëm në poezi ai ka botuar : Rrënjët, 1972, Ku e ka folenë bilbili, 1982, Si vdes gruri 1994, Letër Hamurabit, 1997, Somnamb, 2002, Lulekumbullat, (poezi përkythyer nga Konfucij) 2002, Psalm për atin, 2003, Përdimim me pak

natë, (poezi të zgjedhura), 2004, Fytyrë e panjohur, 2005 Poezi (shqip dhe maqedonisht), botim i Shoqatës së shkrimtarëve të Maqedonisë, Shkup 2010, Këngë të Solomonit, 2017. Është përkythyer në disa gjuhë e si poet ka marrë çmime kombëtare (Penda e Argjenditë, 1998) dhe çmime të tjera rajonale. Poezia e tij është dhimbje dhe revoltë e heshtur. Nuk del rrugëve për përmbysje por vjen e trashet e bëhet gungë në gjoksin e poetit. E krahas saj, e pas saj, lexuesi njih një lirizëm original, një vlinë që qan. Ndoshta kërkon ta mbjellë zemrën tek tjetri. Dhe zgjatet si puthje. Dhe bleron si pemë. Pa ndrojtë mund të them se Sadik Bejko është poet i bregës. Një zë i veçantë që kumbon në heshtje. Në penën e poetit kjo thith pluhurat nga tunelet e territ, diell që shkrin netët e ngricave". Poeti e gjen pozicionin e vet. Te "Pylli dhe lakuriqu i natës" shkruan se kjo botë, pyll pa ajër, pa gjethë pa zogj e pa cerdhe e përhumbe terr as trajta as njerëz E shpiti në vetmi di, "më e mira: rrënjë në tokë se sa dega sipër / po flete me gjarpër zgjoresh me dhelprë dhe fillikat". Te poezia "Letër mikut të mërguar" malli për vendlindjen është kthyer në një bregë që të djeg shpirtin, rrepet ulërinë si gojë demashbraktisje tej e tej e ai gjarpri i vendlindjes kafshon, e djemtë na ikin në moskthime, ndonjë plakë e vetmuar sjell në qytet ndonjë tufë bari me aromë, ku fsihet një cipëz qielli që nuk e shohim Nuk është "Thirrja e udhës" është ulërima e ikjes së verbër drejt lirisë e fatit të errët, dorëzimi i kokës së prerë, molla e pjekur këputur me gjithë degë, grykat lart, poshtë humnerë; është fati, fati ynë, fati "Zgjatim kërkthizën, tërkuzën e djepit tonë / e lidhën në rrufë, në rreze dielli qi ther, e lamë pas si shtizë të tendosur / te një urë varur; harkuar në ybler".

NË VEND TË EPILOGUT

Poezia e Bejkos mbart një shigjetë që godet qiellin, msa ai nuk është i kaltër: Te "Ujku" poetofara e tij godet edhe genin e vet, ADN-në. Ai "vë kujën jam unë ujku tani Si ati a gyshti, dhe unë, dhe im bir apo ai që vjen më pas "ulërin". Tani ujku është ai. Egërsi gjenetike kjo ulërimë. E pse jo? Ndoshta dhe krenari, guxim, egërsi, aventura, bukuri e egër; brez pas brezi këshuta. Te "Uria e keqe" (monologu i lumit) poeti flet me vete. Si lumi. Dhe si lumi e ka urinë të keqe. Ha dhëra, gurë e shkëmbinj. Dhe brinjët i epen gjer në krisë. Shpatullat e buta i ka prej dallge. Se dhe balta (që ha) dhe gurët dhe bregu i betonohen në cdo hap. Është i brishtë poeti Me buzët e lumit qepur nga shku-ma. Po ka uri. Uri. Të egër: Të thellë. Sfilëtes. Si lubi. I zi lumë (lexo, i zi poet) nuk e mund do bregun e ashpër. Dhe si Krishti e mbart buzëqeshjen e urisë, atë dhimbjen therëse mbi shpinë. Bregë. Ashu-të rëndë si gurë e shkëmbinj. Dhe Flet me vete. Dhe ecën kokëllart për në det. Se vetëm deti e njeh uronin e lumit. Si koha që rrjedh e vonon vlerësimin e vërtetë të poetit. Po Sadik Bejko mund të kujtojë Czeslaw Milosz-in dhe atë mërmërimin e tij: "Më fal, poezi, nëse është faj që nxora / këtë zë dhimbjeje".

NOMINIMI

KADARE DHE ORHAN PAMUK

Kandidatë për çmimin letrar ndërkombëtar në Britani

Shkrimtari i njohur shqiptar, Ismail Kadare, është një nga 6 finalistët e çmimit europian të letërsisë "EBRD" që jepet nga Banka Europiane për Ndërtim dhe Zhvillim. Romani i tij "Kamarja e turpit" që në gjuhën angleze është përkthyer me titullin "Niche Traitors" është shkruar 40 vjet më parë dhe është botuar në gjuhën angleze vitin e kaluar.


"Kamarja e turpit", e përkthyer në anglisht nga John Hodgson, në shqip është botuar për herë të parë më 1978, si pjesë përbërëse e librit "Ura me tri harqe", me titullin "Pashallëqet e mëdha". E shkruar në një nga periudhat më të errëta të letërsisë, "Kamarja e turpit", është pjesë e një trashëgimie historike letrare, e cila pavarësisht diskutimeve me të cilat shpesh përballet, do jetë gjithnjë pjesë identitare e letërsisë sonë. Kadare e fillon historinë e tij nga këndvështrimi i një njeriu të zakonshëm, 31-vjeçari Abdulla, i cili është roja i kamares së turpit. Romani që ka në qendër fatin e Ali Tepelenës, pashait rebel shqiptar, që u ngrit kundër sulltanit dhe shtetit osman, është konsideruar nga kritika botërore si një nga veprat më tragjike të Kadaresë, ku përshkruhet terrori shtetëror.

"Ismail Kadare satirizon dinakun Hoxha", titullohej shkrimi i botuar në revistën "The Spectator" ku promovohet romani në gjuhën angleze. Sipas autorit, romani është një parodi e diktaturës komuniste dhe "Në 'Kamaren e Turpit', spastrimet e diktatorit shqiptar tinëzish janë fshehur nën gjakmarrjet e Ali Pashës në shekullin XIX". Autori përshkruan krijimtarinë e Kadaresë në një atmosferë të rënduar tiranike dhe vlerëson mënyrën se si ai ka arritur të kritikojë sistemin përmes letërsisë. Gjaku, thonë ata, shkon shpejt në thikë, në Shqipëri, ku vrasjet për hakmarrje të stilit ballkanik janë njohur që në kohët e lashta, edhe për çështje pronësish. Mekanizmi i hakmarrjes, ideja e vjetër e pastrimit me anë të gjakut - është trajtuar nga shkrimtari shqiptar.

"SHORTLISTA"

Çmimi i letërsisë "EBRD 2018" jepet për herë të parë këtë vit. Fituesi i çmimit shpallet më 10 prill dhe merr shumën prej 20,000 euro.

Çmimi i BERZH vjen në partneritet me British Council dhe Panairin e Librit në Londër. Në njoftimin e shpërndarë për mediat, shënohet se çmimi synon të ofrojë një mundësi unike për të reflektuar kulturën dhe kreativitetin në 40 vendet ku banka operon dhe investon, nga Maroku në Mongoli, Estoni dhe Egjipt. Çmimi do t'i jepet përparësi të mirë



Në foto:
Kopertina e librit



të letërsisë që është përkthyer nga gjuha origjinale në anglisht dhe është botuar nga një botues në Mbretërinë e Bashkuar nga 18 maji deri më 15 nëntor 2017. Shuma ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet autorit dhe përkthyesit, duke bërë që të vlerësohet arti i përkthimit po aq sa pasuria, thellësia dhe shumëllojshmëria e artit dhe historisë së jashtëzakon-

"Kamarja e turpit", kryetarja e jurisë: Një komedi të zezë nga Shqipëria

shme në vendet ku banka operon. Juria ka përzgjedhur gjashtë romane që i konsideron të jashtëzakonshme.

Gjashtë romanet e shortlistës janë:

"All the World's a Stage" shkruar në rusisht nga **Boris Akunin** (përkthyer nga Andrew Bromfield);

"Belladonna" shkruar në kroatisht nga **Dasa Drndić** (përkthyer nga Celia Hawkesworth);

"Kamarja e turpit" shkruar në shqip nga **Ismail Kadare** (përkthyer nga John Hodgson);

"Gruaja me flokë të kuq" shkruar në turqisht nga **Orhan Pamuk** (përkthyer nga Ekin Oklap);

"Istanbul Istanbul" shkruar në turqisht nga **Burhan Sönmez** (përkthyer nga Ümit Hussein);

"Maryam: Keeper of Stories" shkruar në arabisht nga **Alawiya Sobh** (përkthyer nga Nirvana Tanoukhi);

JURIA

Në juri bëjnë pjesë Peter Frankopan (Profesor i Historisë në Universitetin e Oksfordit), Gabrieli Gbadamosi (poet, dramaturg, eseist), Lucy Hannah (shkrimtare, producente, themeluese e sh-

krimtarëve të Commonwealth-it) dhe Rosie Goldsmith kryetare e jurisë (gazetare e vlerësuar me çmime).

Goldsmith tha se "Ky çmim është ndryshe dhe i rëndësishëm. Ka të nominuar nga Armenia në Shqipëri, nga Balltiku në Ballkan dhe më gjerë. Ky çmim e ka zgjeruar botëkuptimin tim dhe përkufizimin tim për romanin. Kemi lexuar një roman të një feminesteje turke, një tregim dashurie nga Bejruti, një kujtim nga Maroku, një komedi të zezë nga Shqipëria dhe një satirë shpërthyes ruse - dhe këta janë vetëm disa prej shkrimtarëve që po përmend, por standardi i rrëfimit dhe i përkthimit është i shkëlqyeshëm dhe fituesit tanë do t'ju bëjnë për vete".

Më tej, Colm Lincoln, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i EBRD, komentoi se: "Ne shpresojmë që çmimi i letërsisë EBRD jo vetëm të nxjerrë në pah më të mirën e fiksionit të përkthyer, por, gjithashtu, të inkurajojë botuesit në botën anglishtfolëse për t'i dhënë më shumë rëndësi historive të shkëlqyera të shkruara në arabisht, turqisht, në pafundësinë e gjuhëve sllave dhe në ato të rajonit më gjerë. Shumë pak lexohet veprat e përkthyer në gjuhën angleze".

ÇMIMI

Çmimi i parë prej 20,000 euro do të ndahet në mënyrë të barabartë midis autorit fitues dhe përkthyesit. Ndërsa të tjerët do marrin 1,000 euro secili. Tre librat finalistë do të shpallen në fillim të marsit 2018.

Fituesi do të shpallet në Londër në një ceremoni në selinë qendrore të BERZH-it në "One Exchange Square", Londër, më 10 prill 2018, çka përkmon Panairin e Librit në Londër.

Një eveniment i veçantë do të mbahet gjithashtu në Panairin e Librit të Londrës më 11 prill 2018, që këtë vit ofron edhe libra nga vendet baltike, një nga rajonet ku operon BERZH-i.

Çmimi i letërsisë i EBRD është një projekt i Bankës. Programi Kulturor i Bankës promovon film-in, muzikën dhe letërsinë nga rajonet në tranzicion. BERZH u krijua në 1991 pas rënies së Murit të Berlinit për të përmbushur sfidën e një momenti të jashtëzakonshëm në historinë e Evropës: kolapsi i komunizmit. Është një bankë shumëpalëshe me pothuajse 70 aksionerë që promovon zhvillimin e sektorit privat dhe iniciativave sipërmarrëse në 37 ekonomitë në tri kontinente. (f.n.)

E shkruar në një nga periudhat më të errëta të letërsisë, "Kamarja e turpit", është pjesë e një trashëgimie historike letrare, e cila pavarësisht diskutimeve me të cilat shpesh përballet, do jetë gjithnjë pjesë identitare e letërsisë sonë.

Agresorët i marrin edhe "Volkswagen"-in

Maskat grabisin me armë para dhe bizhuteri në banesën e 36-vjeçarit



FUSHË KRUIË - Një 36-vjeçar nga Fushë-Kruja ka përjetuar ferrin mbrëmjen e së dielës, pasi është përballur me persona të armatosur dhe të maskuar. Mësohet se grabitësit kanë hyrë në banesën e shtetasit Blerim Kaloshi, të cilët i kanë marrë nën kërcënimin e armëve një shumë parash dhe bizhuterish. Mësohet se agresorët nuk janë mjaftuar me kaq, por i kanë marrë 36-vjeçarit edhe një autom-

jet tip "Volkswagen". Pas sinjalizimit për grabitjen në banesën e shtetasit në fjalë, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. "Më datë 04.02.2018, rreth orës 21:30, në Fushë-Krujë, persona të paidentifikuar me maska, të dyshuar të armatosur kanë hyrë në banesën e shtetasit B.K. dhe duke e kërcënuar, kanë marrë një shumë parash, bizhuteri dhe një mjet tip "Volkswagen". Me

të marrë njoftimin, në vendngjarje kanë shkuar efektivet e policisë dhe është ngritur grupi hetimor. Uniformat blu kanë shoqëruar disa persona, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve. Materialet i kaluan prokurorisë së Krujës për veprime të mëtejshme për veprën penale. "Vjedhja me dhunë" e kryer në bashkëpunim", thuhet në njoftimin e policisë.

U merrte para qytetarëve për të kaluar kufirin, arrestohet polici

POGRADEÇ - Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në Ministrinë e Brendshme ka arrestuar dje një oficer të Policisë Kufitare për korrupsion pasiv. Bëhet fjalë për Ardian Hoxhën, 32 vjeç, me detyrë përgjegjës turni në pikën kufitare të Qafë-Thanës. Mësohet se SHÇBA në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec e hetonte me metoda speciale efektivin që prej 3 muajsh. Burime nga policia bënë me dije se dyshohet që Hoxha kundrejt pagesave lejonte kalimin e shtetasve të ndryshëm, që nuk mund të udhëtonin në drejtim të Maqedonisë dhe zonës Shengen. Ndërkohë që hetimi në lidhje për këtë çështje vijon me qëllim zbulimin e personave të tjerë të implikuar. SHÇBA fton qytetarët të denoncojnë çdo rast paligjshmërie të konstatuar apo korrupsioni, ku janë të implikuar punonjës të policisë, në numrin falas 0800 90 90 ose të shkruajnë në adresën ankesa@shcba.gov.al.

SHKURT

They urdhurin e gjykatës italiane, kapet 46-vjeçari VLORË

Një 46-vjeçar nga Vlora është arrestuar nga policia mbrëmjen e së dielës, pasi rezultonte person në kërkim. Grigor Lamaj kish të thyer masën e sigurisë "Arrest shtëpie" të caktuar nga Gjykata e Milanos, duke u larguar nga vendqëndrimi që i ishte vendosur nga autoritet italiane. Mësohet se Lamaj ishte dënuar nga Gjykata e Milanos me 8.1 vite burg për veprën penale "Organizatë kriminale në bashkëpunim, ndihmë dhe favorizim prostitucioni". Uniformat blu sqaruan se ndalim i tij u bë me qëllim ekstradimi drejt vendit fqinj.

Plagosi me çifte hallën, arrestohet

SARANDË - Policia e Sarandës ka arrestuar një 45-vjeçar, pasi ka plagosur pa dashje hallën e tij. Sipas bluve, në pranga është vënë Jetnor Xhaferri, banues në fshatin Pandalejmon, Finiq. Mësohet se ai u kap, pasi të dielën, teksa ishte në gjueti, ka qëlluar me armën e gjahut, të cilën e mbante pa leje dhe për pasojë ka plagosur e dëmtuar lehtë në fytyrë, hallën e tij, shtetasen Z.M. Pas sinjalizimit për ngjarjen, blutë kanë prangosur 45-vjeçarin, ndërsa kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e gjahut. Materialet hetimore në ngarkim të Jetnor Xhaferri do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprime të mëtejshme.

Drogë drejt Greqisë, prangosen 2 të rinj

SARANDË - Dy persona janë arrestuar në qytetin e Sarandës gjatë një operacioni antidrogë. Florian Balliu, 29 vjeç, banues në Fier dhe Amarildo Derstila, 26, banues në Elbasan, u kapën me afro 21 kg drogë të llojit kanabis në automjetin e tyre. Sipas policisë, dy të rinjtë kishin si qëllim ta trafikonin drogën në Greqi. Autoritetet gjithashtu kanë shpallur në kërkim 21-vjeçarin R.K., banues në Fier, si bashkëpunëtor në këtë veprë penale.

Ngjarja në qershor të 2016-ës, vrasësi me pagesë rrezikoi jetën e shumë personave

Atentati ndaj Çapjas, prokuroria ndryshon akuzën për Hasanpapajin
20-vjeçari akuzohet për vrasje të mbetur në tentativë

ELBASAN

Prokuroria e Elbasanit ka ndryshuar akuzën për 20-vjeçarin Shkëlzen Hasanpapaj, i dyshuar si vrasës me pagesë i bandës rivale të Çapjave. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore ndaj autorit të atentatit të vitit 2016, ku mbeti i plagosur Bledar Muça dhe një efektive policie, prokuroria ndryshoi akuzën ndaj tij nga "kanosje" në "Vrasje të mbetur në tentativë" duke rrezikuar jetën e shumë personave. Mësohet se i pandehuri ka 10 ditë afat për t'u njohur me akuzën e re. Vetëm pak ditë më parë në nisjen e seancës ndaj tij, forca të shumta policie "blinduan" gjykatën dhe Prokurorinë e Elbasanit. Blutë ushtruan kontrolle të rrepta në të gjithë zonën ku ndodhen institucionet e drejtësisë në këtë qytet para fillimit të seancës. Shkëlzen Hasanpapaj akuzohet si autor i atentatit të 6 qershorit të vitit 2016. Ai qëlloi disa herë me kallashnikov në një automjet tip "Golf", ku brenda tij ndodheshin Florec Çapja dhe Bledar Muça, dy emra të njohur të botës së krimit në Elbasan. Nga të shtënata mbeti i plagosur Muça si dhe efektiva e policisë, Matilda Kërmezi.

ATENTATI
Shkëlzen Hasanpapaj akuzohet si autor i atentatit të 6 qershorit të vitit 2016 në qytetin e Elbasanit. Ai qëlloi disa herë me kallashnikov në një automjet tip "Golf", ku brenda tij ndodheshin Florec Çapja dhe Bledar Muça, dy emra të njohur të botës së krimit në Elbasan. Nga të shtënata mbeti i plagosur Muça si dhe efektiva e policisë, Matilda Kërmezi.



Vendi ku ndodhi atentati

arrestuar në Holandë dhe më vonë u ekstradua drejt Shqipërisë. Ndërsa pritej që ai të përgjigjej për atentatin në fjalë, prokuroria zbuloi akuzat ndaj tij. Konkretisht, i riu u akuzua për veprat penale: "Kanosjes me armë", "Armëmbajtje pa leje" si dhe ajo "Plagosjes së

lehtë me dashje" në dëm të Bledar Muçës dhe efektives së policisë, Matilda Kërmezi. Pas skandalit të ndryshimit të akuzave nga "Vrasje në rrethana cilësuese të një ose më shumë personave mbetur në tentativë" në "Kanosje me armë", "Plagosje e lehtë me dashje" dhe "Armëmbajtje pa

leje", Drejtoria e Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme nisi kontrollin e veprimeve hetimore dhe administrative që janë kryer me këtë dosje. Pas emërimit të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku, objekt i inspektimit u vendos që të ishte edhe ish-

prokurori i Elbasanit, Dritan Gina, cili ka menaxhuar procedurën e ndërrimit të prokurorëve, derisa në fund çështjen e ka pasur në dorë prokurorja Eliverta Murra, e cila më 27 dhjetor 2017 ka mbyllur hetimet duke akuzuar Hasanpapajin për tri akuzat e lartpërmendura.

SHKODËR

Që pas marrjes së detyrës, kryeprokurorja Arta Marku për herë të parë ka marrë pjesë në një analizë njëvjeçare në Shkodër, ndërsa pritet që të vijojë edhe në prokuroritë e rretheve të tjera. Dje, në Shkodër është zhvilluar analiza e punës njëvjeçare e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor dhe asaj të Apelit. Drejtuesit e këtyre prokurorive për rreth një orë kanë raportuar mbi atë që ka ndodhur në këto



Analiza e punës së prokurorisë, Marku vartësve: Më të afërt dhe më transparentë me qytetarët

institucioneve gjatë vitit 2017. Gjatë raportimit janë bërë të ditura edhe problematikat që janë hasur gjatë vitit që shkoi. Ndërkëq, gjatë fjalës së saj, Marku u është drejtuar prokurorëve duke i thënë se në lidhje me reformën në drejtësi duhet që ta njohin mirë dhe të bëjnë kujdes për gjithçka.

Po ashtu, kryeprokurorja ka lënë një mesazh të qartë lidhur me imazhin e prokurorit, duke kërkuar që përmes punës së tyre, ky imazh të përmirësohet dhe të ketë një perceptim tjetër ndryshe nga deri tani. Marku u ka bërë me dije vartësve se duhet që të kenë një qasje tjetër, duke

qenë më të afërt dhe transparentë me qytetarët, por edhe me një komunikim ndryshe. Porosia e fundit e kryeprokurores lidhet me raportin e prokurorëve me mediat. Znj. Marku kërkoi t'i mbajë sa më larg mediat nga prokurorët, duke u thënë këtyre të fundit se duhet të japin informacion

aq sa lejon ligji dhe jo më shumë. Pas këtij takimi, kryeprokurorja ka zhvilluar edhe një mbledhje më të ngushtë me disa prej drejtuesve dhe prokurorët kryesorë në Shkodër. Këto takime në rreth të znj. Marku vijnë pas firmosjes së marrëveshjes me Ministrinë e Brendshme, marrëveshje kjo që sipas burimeve, mund të zëvendësojë SPAK-un që parashikon reforma në drejtësi.

Opinion *i* Ditës

Nga Dritan Hila

Arrestimi cironkave që mund të sjellë peshqit

(Vijon nga faqja e parë)

... që prisnin, ndërsa pjesa tjetër nuk besojnë se këtyre çështjeve do t'u shkohet deri në fund. Ka prej atyre që besojnë se ky është filli që do të çojë tek politikanët e lartë, ashtu siç ka të tjerë që mendojnë se është vetëm 'show' mediatik.

Megjithatë, është herët për të folur. Një gjë është e sigurt, që rrugët dhe bujqësia janë dy sektorë ku abuzimin e mbulon dheu, ose e merr ujë.

Gjithsesi, zyrtarët e arrestuar janë zyrtarë të nivelit të dytë. Secili prej tyre ka lëvizur me miliona euro, të cilat janë përfolur shumë. Dhe nuk bëhet fjalë për rrugë fshati, por për akset kryesore të vendit, siç janë Rruga e Kombit dhe ajo Tiranë-Elbasan. Ndërkohë abuzimi, kontratat e pasakta kanë bërë që të mbesin të papërfunduara shumë akse. E megjithatë, asnjëri prej këtyre figurave nuk kish të fuqinë që të abuzonte me fondet e publike pa një mbrojtje politike. Madje të nivelit të lartë. Asnjëri prej tyre nuk do të mund të ruante për vite të tëra pozicione drejtuese pa pasur abuzime. Por, është ende herët për të folur.

A ka prapavijë politike në këto goditje? Ajo që bie në sy është se të arrestuarit janë nga radhët e partive të opozitës. Mbesim në pritje që të duken edhe emrat e parë nga forca që ka pesë vjet në qeveri.



Në këto orë të para gjithçka mund të thuhet është që mënyra më e mirë është të mbesim, ashtu si publiku, skeptikë. Nëse janë të pafajshëm, nëse

këta janë koka turku, apo e gjitha është një shfaqje, nuk do duhet shumë kohë për ta marrë vesh. Gjithsesi, publiku pret të shikojë se në xhepat e kujt

ka shkuar rritja ekonomike vjetore e vendit, i cili ka mbi dhjetë vjet që rritet vetëm në letër dhe zbrazet në realitet. *dritare.net*

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta vipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

HOROSKOPI

DASHI

Pozicioni i planetëve do t'ju garantojë një ditë të gëzueshme dhe pa kokëçarje, gjatë së cilës do të rreni mirë! Shmangni nga programi çdo lloj veprimtarie të lodhshme, dhe mendoni të argetoheni, ose nëse doni, mendoni të argetoheni.

DEMI

Kjo ditë ju sjell paqe dhe qetësi, që t'ju përkushtoheni punëve të shtëpisë dhe të kaloni mjaft kohë me familjen tuaj. Edhe pse kinematja nuk ishte në programin tuaj, përmbyshjani dëshirën për partnerit për ta bërë të lumtur.

BINJAKET

Do të ndiheni pak të paqëndrueshëm. Fatmirësisht, sot do të keni pak kohë për të rimarrë energji dhe të largoni kështu stresin. Duke qenë se nuk do t'ju duhet të merreni me shkresa, shkoni në kuzhinë dhe filloni të përgatitni një ëmbëlsirë për drekë.

GAFORJA

Edhe pse do të keni një rënie të lehtë të energjisë, për pjesën tjetër të ditës mund të rritni të qetë në shtëpi pa u dëruar se mund t'ju kërkojë dikush. Por nëse ka nevojë për ndihmën tuaj, mos e mohoni, edhe pse do të kishit parapëllyer të rritni pa bërë gjë.

LUANI

Të veshur me elegancë dhe gati për të festuar, jeni të parët që shkoni për të vallëzuar dhe të fundit që ikni. Planetët ju mbështesin. Jeni të pandalshëm dhe me vështrësi dikush mundohet t'ju frenojë. Por ndërkaq mos e teproni shumë.

VIRGJERESHA

Mos e zmadhoni shqetësimin që vjen nga mungesa e harmonisë hënore dhe mos u angazhoni për të bërë të ecin përpara shumë detyra. Rezultati do të ishte zhgënjës. Vendosni përparësi, duke u marrë me një gjë të vetme e duke bërë më të mirën.

PESHORJA

Ditë e përsosur për sportin, nëse ju pëlqen ndonjë disiplinë sportive. Plutoni dhe Uranin do t'ju japin një ndihmesë të vyer për të thyer ndonjë rekord. Ajo që është e sigurt është se nuk duhet të përtoni, por të mendoni për mirëqenien e juaj.

AKREPI

Nëse nata për ju ka qenë e gjatë dhe keni fjetur pak, pozicioni i Saturnit dhe Jupitrit do të bëjë që këtë ditë të jeni të prirur t'i përkushtoheni qetësisë. Nuk jeni prej çeliku, edhe pse keni një rezistencë të mirë. Duhet t'i jepni rëndësinë e duhur pushimit.

SHIGJETARI

Gjatë ditës së some nuk duhet të bëni gjë tjetër përveçse t'ia lini instinktit tuaj të lindur t'ju udhëheqë drejt harmonisë. Në dashuri do të jepni më të mirën; do të dini të jeni të jeni partner të dashur dhe të kujdesshëm, plot me dashuri në zemër.

BRICJAPI

Është e vërtetë se me vullnet arrihet çdo gjë, por është e rëndësishme edhe të nxitri në pah ndjenjat tuaja. Jini të vëmendshëm dhe pritni kërkesat e partnerit. Në çift ka nevojë t'i jepni më shumë hapësirë dialogut, për të thelluar mirëkuptimin.

UJORI

Bashkëveprimi i favorshëm i planetëve në qellin e juaj dhe ju ndihmon të rivendosni gëzimin dhe të gjallëroni lidhje dashurore të shuara. Mos u ktheni mbrrapa, nëse dikush ju paraqet një ftesë. Mund t'ju jepni të gjithëve gëzim dhe qetësi.

PESHQIT

Nëse disa çështje do të kërkonin vëmendjen tuaj urgjentisht, nuk keni çfarë t'i bëni, por mos e ekzagjeroni. Do t'ia dini nga një situatë ku duhet të kënaqni dy palë, nëse nuk do t'ia arrini nga zgjuarsia, do të jetë me pak fat që nuk e prisnit.


Dje në "Europa e lirë"

Nga Valona Tela

(Vijon nga faqja e parë)

... pranimit të mundshëm në BE në vitin 2025, ndërsa datat e integrim-it evropian të vendeve të tjera të rajonit nuk do të përmenden. Kështu thuhet në versionin përfundimtar të Strategjisë për Perspektivën e Besueshme të Ballkanit Perëndimor, teksti i së cilës u miratua të hënën në takimin e shefave të kabinetit të Komisionit Evropian. Në dokumentin që ka siguruar radio "Evropa e Lirë", Mali i Zi dhe Serbia identifikohen sërish si lidere në rajon dhe pranimi i tyre në BE parashihet të bëhet për shtatë vjet. "Negociatat për pranimit janë duke u zhvilluar me Malin e Zi dhe Serbinë. Me vullnet të fuqishëm politik, me reforma reale dhe të qëndrueshme, si dhe me zgjidhje përfundimtare të kontesteve me fqinjët, këto dy vende do të jenë potencialisht të gatshme për anëtarësim në vitin 2025", thuhet në tekstin e Strategjisë së Komisionit Evropian, e cila do të publikohet të martën në Strasburg. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nga ky dokument do të sigurojnë vetëm perspektivën për integrim evropian, pa afate kalendarike për pranimit e tyre të mundshëm. "Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në bazë të kushteve të plotësuara. Me përpjekje dhe angazhim të vazhdueshëm, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet kandidatë për anëtarësim. Kosova ka mundësi të bëjë përparim të qëndrueshëm me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të avancojë në rrugën e saj evropiane kur të lejojnë rrethanat objektive", thuhet në Strategji. Në këtë dokument, Bashkimi Evropian ka ashpërsuar gjuhën në kapitullin për sundimin e ligjit. Ai qartë paralajmëron se vendet e rajonit do të bëhen anëtare të BE-së, "por jo në gjendjen ku janë sot".

"Sot, vendet tregojnë elemente të qarta të shteteve 'të kapura', përfshirë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe përzjerje të fuqishme të interesave publikë dhe privatë", thuhet në Strategji. Strategjia po ashtu vë në dukje se në rajonin e Ballkanit Perëndimor



ekziston "ndërhyrje e gjerë politike në media dhe kontroll mbi to". "Gjyqësori i fuqishëm dhe i pavarur, si dhe qeveritë dhe administratat e përgjegjshme janë të domosdoshme për të bërë ndryshime të qëndrueshme shoqërore, të cilat janë të nevojshme", thuhet në dokument. Strategjia për Ballkanin Perëndimor vë theksin mbi dy çështje të rëndësishme, që ndikojnë në të gjithë rajonin dhe që duhet të zgjidhen përpara se ndonjë vend i rajonit t'i bashkohet BE-së: "Dialogu midis Kosovës dhe

Serbisë dhe mosmarrëveshjet dypalëshe". "Nuk mund të ketë qëndrueshmëri të përhershme në rajon pa normalizim efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, përmes dialogut që e ndihmon BE-ja. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërishit e detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve është urgjente dhe vendimtare, në mënyrë që Kosova dhe Serbia të përparojnë në rrugën evropiane", thuhet në tekstin e Strategjisë, e cila parashikon që një

marrëveshje e tillë të arrihet deri në fund të vitit 2019. Rreth çështjeve të hapura dypalëshe midis vendeve të rajonit, Strategjia thotë se para pranimit të tyre në BE, ato duhet të gjejnë dhe zbatojnë "zgjidhje përfundimtare dhe të detyrueshme". "Bashkimi Evropian nuk mund dhe nuk do të prezantojë mosmarrëveshje dypalëshe", thuhet në tekstin e Strategjisë. Kur bëhet fjalë për problemet e pazgjidhura kufitare midis këtyre vendeve, Komisioni Evropian kërkon që palët "t'i dër-

gojnë në arbitrazh përfundimtar", siç është Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Vendimet e arbitrazhit do të duhet pastaj t'i pranojnë dhe respektojnë të dyja palët, përpara se të futen në BE. Komisioni Evropian ka vënë rejtje konkrete edhe në kapitullin për ekonominë, ku po ashtu thuhet se ka ndërhyrje politike. "Pjesë kritike të ekonomisë në rajon janë jokonkurrenca, me shumë ndërhyrje të panevojshme politike dhe me sektor të pazhvilluar privat", thuhet në tekstin e Strategjisë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Humbja në Kiev dhe barazimi me Kamzën rëndojnë te mbrojtësi i bardhekuqve korçarë

KALENDARI

Përcaktohet java e 19-të, Skënderbeu-Flamurtari luhet të premtën

Java e 19-të e Kategorisë Superiore do të nisë ditën e premtë... Në stadiumin "Skënderbeu" të Korçës, skuadra e Ilir Dajës do të përballlet me Flamurtarin. Dueli mes vendit të parë dhe të dytë mund të përcaktojë shumë persa i përket luftës për titull.

Osmani pret titullin, por ka dy pengje

Në fundjavë vjen Flamurtari i vendit të dytë

Jeton Selimi

Dy fitoret radhazi, në Kupë dhe kampionat, kanë bërë që Skënderbeu t'i rikthehet ritualit të zakonshëm, madje këtë fundjavë shtoi diferencën me ndjekësit. Ndaj Vllaznisë u pa një skuadër që bind në fushë, si një makinë e vërtetë, duke rikthyer në memorie ekipin e fillimit të sezonit, që po shkëlqente në Europë. Goli i Vangjelit, pas asistit të Osmanit, por mbi të gjitha fitorja me përmbysje është një tregues i besimit që kanë korçarët tek aftësitë e tyre. Diçka të tillë e pranoi edhe vetë trajneri Ilir Daja, ndërkohë që kërcënimin e vërtetë e bëri lojtari i ndeshjes, sulmuesi James Adeniyi. "Na duhet shumë punë për të vijuar me këtë ritëm, por synimi ynë është që të fitojmë titullin kampion pa filluar faza e 4-t". Mjafton kjo fjali për të kuptuar se me çfarë morali është Skënderbeu në këtë moment, madje është një mesazh i dërguar ndaj rivalëve, për më tepër që kjo fundjavë do të sjellë edhe një sfidë direkte me Flamurtarin. Nëse Skënderbeu do të vijojë me këtë ritëm, atëherë është e sigurt që objektivi i vendosur, titulli kampion, që pa filluar faza e 4-t, është mëse i arritshëm. Ndërkohë, mbrojtësi shpëgon asistin e golit të Vangjelit, ndalet te Vllaznia dhe e mbyll me pengjet e këtij sezoni. Që janë dy. Osmani po aktivizohet në mesfushë dhe po bën shumë mirë. Batuta nuk i mungon kurrë dhe prononcin për "SuperSport", korçari e nis kështu.

FITORJA
"Fitorja në Shkodër na shërbeu shumë, pasi situata u bë njësoj siç ishte në fund të vitit të kaluar. Paraqitje si ajo në Gjirokastër nuk duhet të përsëriten,



duke marrë parasysh eksperiencën e madhe të ekipit". **ASISTI PËR VANGJELIN**

"Kristi ma kërkon shpesh atë prerje. Pasim i cili nuk na lejohet nga trajneri, pasi ai kërkon të luajmë shkurt dhe afër. Kushtet sa ka bërtitur profesori kur ka parë pasimin, por shqyr që u bë gol".

VLLAZNIA
"E njoh mirë ambientin në Shkodër, pasi kam luajtur dhe vetë. Njësoj është gjithmonë. Cungu dhe Gjoka nuk kanë faj. Trajneri dhe lojtarët nuk duhet të sulmohen, sidomos në një situatë të tillë. Në Shkodër jetojnë të gjithë me futbollin dhe ka presion. Si në Tiranë dhe Shkodër, ndërsa në jemi më të qetë në Korçë. Nëse nuk do ia dilnim sot, do shtohet presioni edhe për ne, por nuk është se të vret njeri nëse ka presion".

PENGJET
"Kam dy pengje këtë sezon, humbjen në Kiev përballë Dinamos dhe barazimin me Kamzën në Korçë. Në rastet e tjera kemi marrë gjithmonë atë çka meritonim", përfundon Tefik Osmani.

ISH-MBROJTËSI I KUQ

Sa pranë transferimit në Seria A, pasaporta djeg Cuculin

Ardian Cuculi ishte shumë pranë kalimit tek Benvenuto në këtë merkato janari, por gjithçka është ndaluar vetëm në momentet e fundit. Ka qenë Federata Italiane ajo që ka bllokuar transferimin, pasi ekipi ku aktivizohet edhe Memushaj e Gjimeshi e ka plotësuar numrin e ekstrakomunitarëve në ekip. Ish-mbrojtësi i Partizanit do të bënte kështu hapin e madh në karrierë, por fakti që nuk ka një pasaportë nga një vend anëtar i Bashkimit Europian e ka ndaluar.



REAGJONË TIFOZËT

Nëpërmjet një deklarate në "Facebook", tifozëri "Ultras Guerrills" bën thirrje për tifozët e tjerë të Partizanit që të mos shkojnë në stadium për të parë ekipin e zemrës, pas kërkesës absurde, siç e cilësojnë tifozët, për t'u paraqitur në stadium me kartën e identitetit. Ata deklarojnë se janë në luftë ndaj represionit të policisë dhe se do të vazhdojnë bojkotin, derisa karta e identitetit të mos kërkohet më nga forcat e policisë. "Duam vëmendjen tuaj për pak caste! Të të gjithë juve që keni qenë prezentë në mjerimin e ndeshjeve të fundit. Të të gjithë atyre që kur e ndjekim ndeshjen,

"Guerrills" akuzon: Represioni policor me urdhër nga larg



veç frymëmarrjes së tyre dhe zhurmë së topit, nuk dëgjojnë asgjë tjetër! Të të gjithë ju që jeni në gjendje të bëni diferencën e stadiumit dhe të teatrit. Ju mundeni, ata VIP-sat nuk munden, përndryshe nuk

shpjegohet pasiviteti (i qëllimtë) që po e kthen stadiumin në një teatër të heshtur! Ju që keni vënë të paktën një herë si cover një koreo tonën, një pyroshow apo një performancë nga shkallët që ju ka bërë krenarë

kërkesë! Ne nuk jemi jashtë stadiumit për kokëfortësi! Vlerat tona nuk mund t'i nëpërkëmbin kollarexhinjtë dhe ata nën uniformë. Ndaj, në respekt të këtyre vlerave, në respekt të familjes sonë, të asaj që ju përfaqësoni për ne dhe të asaj që ju jeni për ne, gjaku ynë i kuq, ju kërkim që ta lini stadiumin të heshtur! Ashu siç policia e do, ashtu siç porositësit e duan duke filluar nga ndeshja me Laçin! Deri sa rregulli absurd që ndodh vetëm në qytetin tonë të hiqet! Me shpresën që t'i vënë gishtin kokës dhe shkallët mjerane të rikthehen të buçasin ashtu siç dimë ne!
Jo identifikimit, jo paragjykitim!

SUPERLIGA

JAVA E 19

TË PREMTËN

Skënderbeu - Flamurtari

(ora 18:00)

TË SHTUNË

Kukësi - Kamza (ora 14:00)

Lushnja - Vllaznia (ora 14:00)

Partizani - Laçi (ora 17:00)

Teuta - Luftëtari (ora 17:00)

MADRILENËT NË KAOS



Plas sherri në Madrid, edhe Ronaldo kundër Zidanit

Tekniku Zidan është më i rrezikuar se kurrë që të largohet nga pankina e Realit të Madridit. Mediat spanjolle bëjnë të ditur se teknikut francez i është vendosur kush nga Perez që duhet të fitojë me doemos dy sfidat e ardhshme, atë kundër Sociedadit në

kampionat dhe sfidën kundër PSG-së në Ligën e Kampionëve. Reali i Madridi dështoi në fundjavën e kaluar kundër Levantes, sfidë kjo që u mbyll në barazim 2-2. Por vëmendjen e mediave e mori zëvendësimi i Kristiano Ronaldos. Zidan e largoi yllin por-

tugez nga fusha e lojës, pa varësish se Reali po kërkonte fitoren gjatë atyre minutave të fundit lojë. Portugezi nuk e priti mirë këtë zëvendësim dhe zhgënjimi i tij u pa qartë kur u ul në stolin e rezervave. Mësohet se marrëdhëniet mes Ronaldos dhe Zidan janë ftohur dhe raportimi mes tyre nuk është ai i fillimit.

LOJTARI KUQEZI

Memushaj ndihet i kërcënuar, i rrezikohet vendi nga Nasri

Megjithëse merkatoja është mbyllur zyrtarisht, ekipi i Beneventos së Gjimshtitit dhe Memushajt kërkojnë ato pak shanse mbijetese në Seria A. Pasi afruan në ekip Sanjan, tashmë janë pranë nënshkrimit me 2 lojtarë të tjerë. Bëhet fjalë për Aleks Song dhe Samir Nasri, të cilët pritet të luajnë në kampionatin italian. Sipas "SkySport", Nasri do të firmosë së shpejti me këtë klub, teksa aktualisht është një lojtar i lirë, pasi u largua nga Antaliapori i Superligës turke. Transferimi i futbollistit tjetër është paksa më i komplikuar, pasi Aleks Song duhet të largohet fillimisht nga ekipi i Rubin Kazan. Dy futbollistët kanë të drejtë të regjistrohen me ekipin deri me datë 31 mars si lojtarë të lirë. Nasri dhe Song janë emra të dëgjuar për arenën europiane dhe jo vetëm, pasi disa vite më parë kanë qenë pjesë e ekipeve më elitare. Aleks Song ka qenë pjesë e Arsenalit për 6 sezone, e më pas u transferua në Spanjë të Barcelona, fanellën e së cilën e mbajti veshur për 3 sezone. Ndërkohë, Nasri është aktivizuar në kampionatin anglez me ekipin e Arsenalit dhe më pas u transferua te Manchester Siti. Këto dy transferime do ishin një goditje nga ekipi i Beneventos, e cila ka si qëllim kryesor mbijetesën, megjithëse pikët e marra deri tani nuk i japin shumë shpresa.

Pas Bajernit, Napoli, Paris Sën Zhërmen dhe Juventusit. Në ishull titullin e bëjnë fakt

Pikët për ndeshje, Siti mbret në Europë

Kryesuesit anglezë mbledhin mesatarisht 2,65 pikë



Jeton Selimi

Ligat kryesore europiane po i afrohen fazës më të nxehtë të sezonit, aty ku do të përcaktohet shumë në lidhje me luftën për trofe. Në disa nga kampionatet kryesore si ai spanjoll, anglez, gjerman apo edhe francez duket se çështja e titullit është thjesht një formalitet. Barcelona, Manchester Siti, PSG dhe Bajerni i Mynihut kanë distancë të konsiderueshme me ndjekësit, por cila skuadër ka mesataren më të lartë të pikëve në 5 ligat më të rëndësishme në kontinentin e vjetër?

Bajerni ndodhet i pozicionuar në vendin e 6-të. Bavarezët kanë grumbulluar 53 pikë në 21 takime të luajtura dhe regjistrojnë një mesatare prej 2.52 pikësh për ndeshje. Një vend më lart pozicionohet skuadra



kampione e Italisë. Juventusit. Bardhezinjtë, të cilët aktualisht ndodhen pas Napolit në renditje, kanë mbledhur 59 pikë në 23 sfidat të zhvilluara. Mesatarja e

pikëve është 2.57 për ndeshje.

PSG po dominon Ligën franceze, megjithatë parizienët kanë vetëm mesataren e 4-t më të mirë në Europë

me 2.58 pikë. Napoli po kërkon me "shpirt ndër dhembë" triumfin e dytë në histori në Serinë A. Ekipi i Elseid Hysajit ka zhvilluar deri më tani një sezon fan-

tastik në Itali dhe kryeson me meritë renditjen. Në 23 takime të kaltrit kanë akumuluar 60 pikë, për një mesatare prej 2.61 pikësh për ndeshje. Në pozicionin numër 2 gjejmë Barcelonën. "Blugranat" thuajse e kanë siguruar titullin në "La Liga". Mesatarja optimale prej 2.63 pikësh është një dëshmi e qartë e dominimit të katalanëve. Natyrisht, në majën e kësaj renditjeje do të qëndronte Manchester Siti i Pep Guardiolës. Një skuadër vërtet e frikshme në këtë edicion të Premier Leagues. 22 fitore në 26 ndeshje, 69 pikë në renditje dhe një mesatare për t'u vendosur në kornizë: 2.65 pikës për ndeshje. Duke parë shifrat e "Sky Blues" duket vërtet shumë e vështirë që titulli të mos shkojë në "Etihad Stadium".

NË LONDËR

Konte pranë shkarkimit, Çelsi gjen pasardhësin


Mediat britanike e bëjnë të sigurt shkarkimin e Kontes. Sipas tyre, presidenti Abramoviç është futur në bisedime për të sjellë në Londër pasardhësin e tij. Situata tek ekipi i Çelsit po përkeqësohet akoma dhe më shumë me kalimin e ditëve. Përveç lojtarëve, të cilët i kanë dalë kundër Kontes, edhe presidenti Abramoviç ka filluar të mendojë për shkarkimin e tij. Tekniku italian duket se nuk e ka të gjatë në krye të pankinës dhe pasardhësi i tij mësohet të jetë Karlo Anceloti. Ish-trajneri i Bajernit është momentalisht pa ekip dhe po qëndron në Londër, duke shtuar akoma edhe më shumë zërat për një rikthim të tij në pankinën e Çelsit.



SPANJË

Espanjoli hedh në gjyq Pikenë, shkak festimi i golit

Mbrojtësi i Barcelonës, Pike, shpëtoi katalanasit nga humbja e parë këtë sezon në kampionat. Shtatarti spanjoll realizoi golin e barazimit në derbin kundër Espanjolit dhe e ekzagjeroi me festimin e tij. Pike e kishte me tifozët vendës. Pas shënimit të golit, ai u drejtua nga tifozët kundërshtarë dhe iu bëri me shenjë që të mbanin qetësi dhe të mos flasin. Ky gjest i acaroi jashtë mase tifozët, të cilët vazhduan të shanin dhe ofendonin mbrojtësin në kor, gjatë gjithë pjesës së mbetur të takimit. Por skuadra e Espanjolit nuk ka ndër mend ta lërë me kaq dhe është gati të hedhë në gjyq mbrojtësin e Barcelonës. Sipas tyre, gjesti i Pikesë ishte provokativ dhe është më se i ndëshkueshëm.



1 GOL NË 15 NDESHJET E FUNDIT

Bonuçi? Po kush është ky? Juvja është bunker

Largimi i Leonardo Bonuçit dhe problemet e prapavijës së Juventusit në javët e para të kampionatit lanë të mendohej se mos koha e artë e prapavijës së pa-thyeshme të bardhezinjve kishte marrë fund. Por me kalimin e kohës, mbrojtja e Juventusit ka fituar përsëri siguri dhe statistikat tregojnë se tani është kthyer përsëri në kohët e saj të arta. Në 15 ndeshjet e fundit që Juventusit ka luajtur, ka pësuar vetëm 1 gol. Një seri e filluar më 22 tetor dhe kjo tregon më qartësisht formën e prapavijës së saj, që është rindërtuar nga e para pas lëvizjeve të fundit. Dyshja e qendrës, Benatia-Kielini jep garanci, ndërsa Rugani dhe Barzalji janë zëvendësues të lartësisë së duhur në rast emergjencë. Edhe krahët po funksionojnë mirë, me Aleks Sandro dhe De Shiljon që po shfaqen në nivelin e kërkuar. Në momentin kur fillojnë ndeshjet e rëndësishme, për tifozët e Juventusit ky është lajmi më i mirë nga të gjithë.



Në shumë studime të ndara është dëshmuar se qepët e kuqe pengojnë humbjen e flokëve në gati 87% të rasteve. Edhe vetë do të befasoheni me pamjen e flokëve tuaja në afat prej një muaji. Dermatologët thonë se nuk ka pasojë të dëmshme për lëkurën e kokës apo flokët.



Lëngu i qepës rrit flokët "si në ujë"!

ten nga gjenerata në gjeneratë. Metoda me qepët e kuqe kryesisht është mjaft efektive, madje e përdorin edhe persona të njohur hollywoodianë. Në shumë studime të ndara është dëshmuar se qepët e kuqe pengojnë humbjen e flokëve në gati 87% të rasteve. Edhe vetë do të befasoheni me pamjen e flokëve tuaja në afat prej një muaji. Dermatologët thonë se nuk ka pasojë të dëmshme për lëkurën e kokës apo flokët. Qepa e kuqe është e veçantë, sepse është e pasur

me sulfur, i cili nxit prodhimin e kolagenit, që është mjaft i rëndësishëm për rritjen e flokëve. Lëngu i qepëve është i mirë edhe për përmirësimin e qarkullimit në flokë. Gjithashtu, zvogëlon pezmatimin eventual të lëkurës, sepse ka veti antibakteriale. Lëngu i qepëve i bën flokët tuaja më të forta, hap folikulat e flokëve dhe pengon infeksionet në flokë. Ata që kanë përdorur këtë metodë thonë se paraqet rezultate menjëherë pas një muaji. Receta për rritjen e

flokëve me qepë të kuqe: Pastroni dhe bluani dy, deri në katër qepë të kuqe dhe kulloni lëngun e tyre (ose i miksoni në blender dhe pastaj e kulloni lëngun mirë). Në këtë lëng shtoni 1 lugë mjaltë dhe përzieri. Masazhoni kokën flokët me këtë lëng dhe e lini të veprojë rreth 15-30 minuta. Aroma është e fortë por ia vlen. Mund ta mbani madje edhe një orë, nëse nuk nxitoni. Pas këtij trajtimi, lani flokët si zakonisht. Trajtimin duhet përdorur dy deri në tri herë në muaj.



Nëse dëshironi flokë të shpeshta dhe shkëlqyera, kemi recetë të mirë për këtë! A e keni ditur se lëngu i qepëve të kuqe mund të ndihmojë shumë në zvogëlimin e rënies së flokëve, ndalimin e të thinjurit të flokëve dhe njëkohësisht përshpejton rritjen e flokëve dhe përmirëson

cilësinë e tyre? Shpejtësia e rritjes së flokëve definitivisht varet nga gjeni, por për shkak të faktorëve të ndryshëm të jashtëm dhe të brendshëm, flokët tona nuk rriten me shpejtësinë e tyre maksimale. Për këtë mund të ndihmojnë disa preparate shtëpiake, recetat e të cilëve bar-

Qepa dhe mjalti, antibiotikët natyralë



Dy studentë turq kanë vërtetuar në mënyrë shkencore se përzjerja e lëngut të qepës me mjaltin krijojnë një antibiotik natyral, që shëron infeksionet në fyt. Përzjerja e lëngut të qepës me mjaltin krijon një lloj antibiotiku natyral që shëron disa sëmundje. Edhe pse deri më tani kjo përzjerje nuk ishte dëshmuar shkencërisht në ndonjë kongres, këta studentë e dëshmuar në mënyrë shkencore se përzjerja ka efekte më të mëdha se penicilina.


Projekti i kryer nën konsultimin e mësuesve zgjati 4 muaj. Ndërkohë, studentët janë shprehur se rezultatet ishin të mahnitshme dhe se kjo përzjerje ka treguar efekt shumë më të madh ndaj baktereve se penicilina. Edhe më herët ka pasur studime që përzjerja e lëngut të qepës me mjaltë është antibiotik natyral, por asnjëherë nuk ishte dëshmuar shkencërisht.

"Përgatitja është e thjeshtë, qepa qërohet dhe i hapet një vrimë në mes, në të futet mjalti dhe më pas lihet disa çaste derisa ai të shpërndahet në të gjitha fletëzat e saj. Më pas,

qepa shtrydhet dhe lëngu i përfutur pihet", thuhet në studimin e këtyre studentëve. Kjo procedurë duhet të zgjasë derisa të vërehet shërimi dhe duhet të aplikohet një herë në ditë.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Arbana aktore.
7. Kështu janë enigmat.
13. Bëjnë shumë të tilla fëmijët zevzekë.
15. Ishte filmi e Henrikut VII.
16. Fund filmi.
17. Opera me Liu dhe Calaf.
19. Fillojnë një motiv
20. Eshhtë gjahu si çiftija.
21. Bëhen në stacione.
23. Fillojnë romanin
24. Eshhtë policia e FBI.
26. Të parat në stacion.
27. Mund të jepet me medalje.
28. Inicialet e Keaton aktore.
29. Dënosheshin nga Inkuizicioni të tillë.
31. Zanore për papare.
32. Fitohen nga ciklistët.
33. Me beach në një qytetë të Florida-s.

35. Shigjeta e argjenditë e Formula 1.
37. Eshhtë shërbimi me letra
39. Inicialet e Asimov.
40. Një rreth pa ekstreme.
41. Eshhtë syzë në komodinë.
42. Ndezur përgjysmë
44. Janë diletantë.
45. Memoria në computer.
46. Janë engjëjt të Korit të lartë.

VERTIKAL

2. Ishin ushtarët e Pirros
3. Ekstreme në sektor.
4. Një katastrofë.
5. Kapur pa kufij.
6. Një pjesë e territorit.
7. Janë divane të sajura.
8. Janë ndenjësë në park.
9. Eshhtë mbikëqyrje ndaj të miturit.
10. Harris aktor.
11. Qyteti i përjetshëm.
12. Janë filmat me drita të kuqe.
14. Tigri i Malajzisë i Emilio Salgarit.
16. Ai i Madh u udhëhoq nga Mao Ce Dun.
18. Eshhtë vegël e... rrethimit.
22. Fillojnë seftë.
24. Janë besimet e besimtarëve.
25. Janë skuadra.
27. Janë linjat me tragete.
28. I preu Seneka.
30. Një pjesë e relacioneve.
31. Janë vendet ku prehen herojtë.
33. Eshhtë detar si ai i Durrësit.
34. ... Villa në futbollin anglez
36. Loriku kuqezi.
37. Edith e La vie en rose.
38. Një mund të jetë fetar.
41. Janë tek në samba.
43. Bëjnë durim me uri.
44. Në krye të armatës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një Af famëkeq.
7. Eshhtë mjet lundrimi klandestinësh.
11. Ishte kryeperëndi nordike
12. Një pjesë e porosive.
14. Inicialet e Redford.
15. Mund të jetë emërore.
16. Eshhtë vegjetacion.
18. Shkruhet shkurt mm.
19. Inicialet e Turgeniev.
21. Eshhtë e mërztishme.
23. Kështu thomë se është femra
25. Janë pjesë drame.
27. Kanë aderuar në parti.
28. Fillojnë teorinë.
29. Nikola Tesla.
30. Nuk kanë nevojë të rruhen.
31. Derek aktore.
32. Një pije aromatike

VERTIKAL


1. Një spektakël me dema.
2. Negri poete.
3. Kështu e ka punën ai që e ka keq
4. Konak pa kufij
5. Fillojnë nismat.
6. Ishin kaçakë.
8. Eshhtë pika delikate
9. Mali ku ngeci Arka.
10. Zanichchi këngëtare.
12. Janë shoferë të Formula 1.
13. Girona aktor.
16. Janë trarë.
17. Ulen në dhomën e lartë.
18. Janë sandale lëkurëkuqsh.
20. Dhjetë angleze.
21. Gënjëjnë për t'u bërë të famshëm.
22. Emri i Bismarck.
24. Gjysma e leqeve.
26. Janë katalizatorë të organizmit.
31. Duhën vaditur.
32. Kutia kur nuk... ka
33. Kush është... është në moshën e tretë.
34. D'Istria, alias Elena Gjika.
36. Sampras tenis.
37. Marsi i akjeje.
39. Një pjesë e hepatiti.
41. Firar pa kufij
43. Fillojnë tatëpjetën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			2	8	9			
7					5	4		3
9	3	5					1	
	9	4		3	2		8	
			1	6		4	5	
	7		9	8		6	2	
	1					8	5	6
4		2	8					7
		9	7	1				

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	1	8	4	6	9	2	5	7
4	7	2	1	8	5	6	3	9
5	9	6	3	2	7	8	1	4
6	4	9	2	1	8	5	7	3
7	3	1	6	5	4	9	2	8
2	8	5	9	7	3	4	6	1
9	5	7	8	3	2	1	4	6
8	6	3	5	4	1	7	9	2
1	2	4	7	9	6	3	8	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "Gjë e çuditshme lumturia... Vjen vetëm atëherë kur ke mësuar të jetosh pa të".
- "Lumturia nuk gjendet tek lumturia në vetvete, por tek ndjekja e saj. Lumturia nuk është një stacion tek i cili do të arrih. Lumturia është udhëtimi".
Fyodor Dostoevsky
- "Nuk mund ta ndryshosh të kaluarën, por mund të shkatërosh të tashmen, duke u mërztur mbi ato që do të noddhin në të ardhmen".
Woody Allen

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

12	3	9	6	1	10	18	2	4	11	5	1	P	U	S	I	K	U	P	T	O	P			
4	2	6	9	12	3	3	2	6	2	4		U	R	A	R	O	A	S	L	I				
15		8	4	7	3	1	5	1		1	11	14	S	I	P	E	L	E	R	I	N	A	T	
8	4	2	6	1	5	1		6	1	6	9		H	P	A	N	O	R	A	M	A	T		
5	15	18	18	13	3		12	6	2				T	R	I	P	A	N	O	Z	O	M	A	
2	1	7	14	2	2	6	2	7	14	6			E	P	A	T	A	T	I	N	A	T		
10	6	7	6	6	5		1	3	8	6	1		T	E	S	A	I	T	T	O	D			
6	1	4		1	12		10	6		6	7		I	A	R	E	S	P	R	A	N	I	M	E
7		11	6		5		5	7	6	2	1	5	S	T	I	L	E	T	E	U	K	E		
13	10	4	15		1	6	7	5	14	1	5	1	R	U	Z	A	T	R	E					
5	6		4	1		2	4		1	5	11	5	R	I	C	H	A	R	D	T	A			

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	P	M	P	K	A	G	I	M			
T	I	K	M	O	D	E	L	E	T	R	I
K	A	P	I	T	E	N	E	R	I	Z	
P	I	R	A	T	E	R	I	A	S	O	
P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T	R
E	R	C	G	E	R	O	R	A	R	I	
N	O	I	R	E	T	P	E	L	L	E	A
M	T	N	M	A	T	O	R	E	T	A	
L	E	D	S	A	R	A	G	O	N	A	
A	T	T	A	T	E	S	T	E	R	E	
N	E	S	O	N	O	R	S	E	A	T	
G	U	T	T	U	S	O	E	D	I	T	I



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

E	D	L	T	E	C	M	A	F	I	A		
C	K	O	P	E	R	R	A	D	E	R		
O	H	A	R	A	D	I	A	M	A	N	T	I
E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E	T	A
S	T	A	D	I	U	M	E	T	I	R	A	N
D	I	K	A	S	T	E	R	I	R	A		
M	E	N		N	I	S	S	A	N			
N	O	T	A	A	S	U	E	L	E	N	A	
O	R	E	T	R	I	M	A	B	O	N	E	
V	E	S	T	I	M	O	T	E	N	D		
A	A	M	E	N	E	T	R	E	N	E		
K	A	R	A	K	T	E	R	E	T	T	R	

Thënie të mençura

- Një njeri i zgjuar e vendos gjithnjë veten në anën e kundërshtarëve të tij. Eshhtë më tepër në interes të tij, se sa të atyre, që të gjejë pikat e tij të dobëta.
 - Eshhtë më e rëndësishme të parandalosh që një kafshë të vuajë, sesa të rrih ulur e të meditosh për të këqijat e Universit duke u lutur në shoqërnë e pritërnjive.
 - Njeriu duhet të shpëtojë veten me përpjekjet e veta, asnjë nuk mund të bëjë për të, atë që ai duhet të bëjë për veten.
- (Ralf Valdo Emerson)

